

Përmbajtja

Hyrje	05
SEKSIONI I	
Ankesa me objekt "cenimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit"	07
SEKSIONI II	
Ankesa me objekt "cenimin e të drejtave të fëmijëve"	39
SEKSIONI III	
Ankesa jashtë juridiksionit	45
SEKSIONI IV	
Ankesa jashtë afatit	81
SEKSIONI V	
Komunikime tregtare	84
SEKSIONI VI	
Ankesa të ndryshme dhe kerkese per informacion	86

Hyryje

Në një shoqëri demokratike funksionale, media përbën jo vetëm një burim informacioni, por edhe një shtyllë themelore për garantimin e transparencës, mbrojtjen e interesit publik dhe promovimin e lirisë së shprehjes si një e drejtë themelore e njeriut. Megjithatë, kjo liri nuk është absolute, pasi ajo shoqërohet gjithmonë me përgjegjësi të mëdha. Përmbajtjet problematike në media – si dhuna, gjuha e urrejtjes, shkelja e të drejtave të fëmijëve, diskriminimi ndaj komuniteteve vulnerabël dhe shkelja e lirive themelore të njeriut – përbëjnë rrezik të drejtpërdrejtë për dinjitetin njerëzor dhe zhvillimin shoqëror, sidomos në mjedisin e sotëm mediatik që është i gjerë dhe i shpejtë në shpërndarjen e informacionit.

Në këtë kontekst, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) ka një rol kyç e të pazëvendësueshëm për të garantuar që operatorët mediatikë t'i përmbahen standardeve ligjore dhe etike. Prejshumë vitesh, kjo strukturë funksionon si një mekanizëm rregullues dhe mbikëqyrës, duke trajtuar ankesat e qytetarëve mbi përmbajtje të papërshtatshme apo të dëmshme të transmetuara në platformat audiovizive. Përmes

këtij procesi, Këshilli kontribuon në mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtje që çenojnë zhvillimin e tyre, ndalon nxitjen e urrejtjes mbi baza etnike, fetare apo gjinore dhe siguron që liria e shprehjes të mos shndërrohet në "armë" për të dëmtuar apo marginalizuar individë dhe grupe të caktuara.

Trajtimi i ankesave dhe ndërmarrja e masave përkatëse nga Këshilli i Ankesave krijon një mjedis mediatik më të shëndetshëm, të drejtë dhe që respekton të drejtat e çdo individi.

Megjithatë, funksionimi i kësaj strukture ka kufizimet e veta, sidomos përsa i përket trajtimit të ankesave mbi publikime në mediat online dhe platformat e shpërndarjes së videove, përfshirë rrjetet sociale. Ndërkohë që mediat tradicionale – televizioni dhe radioja – janë të rregulluara me një kuadër ligjor të qartë, peizazhi mediatik digjital ka evoluar me ritme të shpejta, duke sjellë sfida të reja për sistemet rregullatore.

Pikërisht për këtë arsye, **struktura e Këshillit të Ankesave është e domosdoshme për të ruajtur ekuilibrin mes lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së të drejtave themelore, por qëndrueshmëria dhe efektiviteti**

i saj kërkojnë jo vetëm përditësimin e kuadrit ligjor, por edhe një vizion të ri e gjithëpërfshirës për rregullimin e medias në epokën digjitale.

Mekanizmi i ankesës nuk duhet parë thjesht si një procedurë administrative ose burokratike, por si një element themelor i funksionimit të shtetit të së drejtës dhe i mjedisit mediatik demokratik. Ai është thelbësor për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, forcimin e llogaridhënies së mediave dhe ofrimin e një informacioni të shëndetshëm, profesional dhe etik.

Pa këtë mekanizëm, rreziku i abuzimit me lirinë e shprehjes rritet ndjeshëm, besimi i publikut në media çënohet dhe vetë struktura e informimit në shoqëri dëmtohet.

Prandaj, fuqizimi, modernizimi dhe përshtatja e vazhdueshme e mekanizmit të ankesës është një domosdoshmëri e kohës sonë, duke e bërë atë një instrument më efektiv përballë sfidave të reja të medias digjitale dhe garant të pandryshueshëm të një mjedisi mediatik të shëndetshëm, të drejtë dhe demokratik.

1

Ankesa me objekt

"cenimin e rregullave

të etikës dhe dinjitetit"

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
E.G.	Media	Programe	15.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi E.G. i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku shprehte shqetësimin e tij lidhur me përmbajtjet audiovizive të transmetuara në mediat shqiptare, si edhe me analizat në studio, të cilat sipas tij realizohen nga individë jo profesionistë të fushës.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës së sipërpërmendur, ankuesit iu bë me dije se:

- Hartimi i katalogut programor dhe sistemimi i formateve në të janë pjesë e **politikës editoriale të OSHMA-ve** dhe, për pasojë, jashtë ndikimit dhe vendimmarrjes së Autoritetit. Në raste të tilla, AMA mund të japë rekomandime, por kurrësi nuk mund të diktojë përmbajtjen audiovizive, të ftuarit apo fashat orare të transmetimit.
- Vendimmarrja dhe kompetencat e Autoritetit – siç përcakton Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, indryshuar, dhe Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023, (indryshuar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024) – kanë në thelb kërkesat për përmbushjen e detyrimeve ligjore, mbrojtjen e audiencës, respektimin e pavarësisë dhe përgjegjësisë editoriale, si dhe ushtrimin e profesionit me pavarësi dhe standarde profesionale, në shërbim të interesit publik.
- Në zbatim të nenit 18 “Objektivat e veprimtarisë së AMA-s”, ky autoritet, në ushtrimin e funksioneve të veta, siguron që:
 - të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimeve fetare, kulturës dhe moralit të shoqërisë;
 - të ruajnë dhe mbështesin vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e

shprehjes dhe të medias.

Ankuesi u informua edhe se AMA, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nuk ndërhyr në përmbajtjen editoriale të OSHMA-ve, por siguron që këto të fundit të respektojnë detyrimet ligjore, standardet profesionale dhe

interesin publik. Roli i Autoritetit është mbikëqyrës dhe rregullues, duke garantuar lirinë e shprehjes, pluralizmin mediatik dhe mbrojtjen e audiencës, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin organik.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Ankues	Digit-Alb, Top-Channel	Big Brother Vip Albania	22.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Dhjetëra ankues iu drejtuan Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin **"Big Brother Vip Albania 4"**, i transmetuar në Top Channel dhe në kanalet e dedikuara **"Big Brother Vip 1"** dhe **"Big Brother Vip 2"** në platformën DigitAlb.

Ankuesit pretendonin se në këtë program audioviziv ishin shfaqur: **"kërcënime fizike, agresivitet, bullizëm, dhunë, fjalor joetik, diskriminim, gjeste dhe shfaqje të papërshtatshme për fëmijët, etj."**

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesave, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjet audiovizive, nga ku konstatoi se në emisionin **"Big Brother Vip Albania 4"**, të transmetuar në datat 14, 17, 20, 21 dhe 23 janar

2025 (ora 16:27:42; 16:35:20; 23:42, etj.) dhe më 4 shkurt 2025 (ora 22:26:00), u evidentuan raste të tilla si:

- transmetimi i sjelljeve agresive dhe bullizmit, deri edhe në përplasje fizike;
- një episod në kuadër të një loje ("**kiss, kiss**"), ku u shënuan tentativë puthjeje pa konsensusin e pjesëmarrëses dhe përballë kundërshtimit të saj të përsëritur;
- përdorimi i fjalorit joetik, sharjeve dhe akuzave të rënda ndërmjet pjesëmarrësve, edhe në fashat orare kur programi mund të ndiqej nga fëmijët;
- debate me tone të larta dhe përmbajtje që cenonin etikën e komunikimit publik.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave konstatoi se këto përmbajtje përbënin shmangie nga Ligji nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, konkretisht neni 4, pika 1/b, pika 1/f; neni 4, pika 2/ç, d, dh, c; si edhe neni 46, pika 2/dh.

Po ashtu, u konstatua shmangie nga

dispozitat e **Kodit të Transmetimit**, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023 (i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024), konkretisht Seksioni 1, pika 1.6 dhe Seksioni 4, pika 4.6.

Në përfundim, Këshilli i Ankesave kërkoi nga OSHMA-të që:

- diskutimet ose përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve të

transmetohen vetëm në fashat orare që garantojnë shmangien e ekspozimit të tyre;

- në rastet kur shmangia është e pamundur për arsye objektive, transmetimi të paraprihet nga një paralajmërim akustik dhe përmbajtja të identifikohet nga prania e një simboli vizual gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
H.B.	TV Klan	Shihemi në gjyq	22.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive i mbërriti një ankesë nga shtetasja H.B. Ankuesja pretendonte se në emisionin **"Shihemi në gjyq"**, të transmetuar në "TV Klan", **"ky emision nuk ka kompetencë ligjore për të hetuar apo analizuar dokumente noteriale"**. Për këtë arsye, ajo argumentonte se programi i kishte cenuar imazhin profesional dhe dinjitetin.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive këqyri përmbajtjen audiovizive të rubrikës **"Shihemi në gjyq"**, transmetuar në "TV Klan" më datë 02.02.2025, ora 17:13.

- Gjatë shqyrtimit të materialit audioviziv u evidentua se, pavarësisht pretendimeve të ankueses, emisioni i kishte krijuar mundësinë e ushtrimit të së drejtës së përgjigjes në media.

Referuar Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s e konsideroi të **ezauruar trajtimin e ankesës.**

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
M.B.	Syri TV	Piranjat	17.02.2025

1. 1. Objekti i Ankesës

Shtetasja M.B. i nisi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin **"Piranjat"**, të transmetuar në "Syri TV". Ankuesja pretendonte se emisioni dhe gazetarët e tij e kishin filmuar me qëllim diskreditimin e figurës së saj profesionale dhe, në shkelje të etikës gazetareske, e kishin "përndjekur" deri pranë banesës.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave ndërmori verifikimin e përmbajtjeve audiovizive të publikuara në edicionet e fundit të emisionit **"Piranjat"**, prej nga rezultoi se:

- Më datë 4 shkurt 2025, emisioni investigativ **"Piranjat"** kishte transmetuar një material me titull: **"TEC-i i paligjshëm i Roskovecit, ja shkeljet e rënda të M.B. dhe E.R."**;
- Emisioni përmbante informacion të lidhur me një investigim mbi procedurat institucionale të ndjekura në kuadër të nismës

për rishikimin e Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec, me procedurë të thjeshtuar;

- Fokusi kryesor i investigimit ishte transparenca institucionale dhe vendimmarrjet me interes publik. Analizës së akteve zyrtare, me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e komunitetit, i ishte kushtuar 44.56% e minutazhit të përgjithshëm të emisionit;
- Interesi i lartë publik argumentohej përmes pasojave të vendimmarrjes për komunitetin, përfshirë protestën e banorëve, të cilës emisioni i kishte kushtuar 4% të minutazhit, duke dëshmuar se çështja përbënte një shqetësim real qytetar;
- Në shërbim të një investigimi të mirëfilltë, që synonte të pasqyronte reagimet e të gjitha palëve, emisioni kishte ndjekur të gjitha hapat institucionale për të intervistuar ankuesen.

Refuzimi i përsëritur dhe sjellja e ashpër ndaj gazetares, përfshirë edhe pengesa fizike, ishin dokumentuar në 14.56% të minutazhit;

- Xhirimet pranë banesës së ankueses përbënin rreth 18.78% të minutazhit total dhe përfshinin shpjegimin e gazetares se ky veprim kishte qenë rruga e fundit e mbetur, pas refuzimeve të përsëritura për intervistë në mjedise institucionale.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga analiza e përmbajtjes, në raport me karakterin investigativ të emisionit, interesin publik dhe ekuilibrat profesionalë, Këshilli i Ankesave gjykoj se:

- Gazetarja kishte ndjekur një linjë të qartë investigative, duke nisur nga analiza e dokumenteve dhe duke u përpjekur të siguronte reagim institucional mbi to;
- Interesi i lartë publik ishte i dukshëm, përmes pasojave konkrete të

vendimmarrjes për komunitetin dhe protestave të banorëve, të cilat shërbenin si bazë legjitime për këmbënguljen në marrjen e reagimeve;

- Refuzimi sistematik nga ana e institucionit justifikonte këmbënguljen e gazetares për të siguruar ballafaqimin e vendimmarrjes me vendimmarrësin;
- Pesha e xhirimeve pranë mjediseve private ishte e vogël në raport me minutazhin e analizës së dokumenteve, përpjekjet për intervistë institucionale dhe përplasjet me përfaqësues të Bashkisë.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave, duke iu referuar përmbajtjes audiovizive të transmetuar nga "Syri TV", **nuk gjeti mbështetje për pretendimet e ankueses për "përndjekje dhe shkelje të privatësisë"**.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajzave	MNC TV	Zonë e Lirë	24.02.2025

1. Objekti i Ankesës

Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza i paraqiti një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin **"Zonë e Lirë"**, transmetuar në MCN TV më datë 07.02.2025. Përfaqësuesit e shoqatës shprehën shqetësimin se, përmes publikimit të të dhënave personale në emision, ishin shkelur të drejtat e privatësisë dhe parimet e etikës.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialin filmik dhe evidentoi se publikimi i të dhënave sensitive mbi pagat dhe shpërblimet e disa drejtuesve të organizatave në vend, si dhe komentet e bëra mbi to nga të ftuarit në studio, binin ndesh me:

- Ligjin nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar (neni 4, pika 2/c);
- Kodin e Transmetimit (pika 1.12 dhe 2.18).

Mosrespektimi i kërkesave të Kodit të Transmetimit për mbrojtjen e të dhënave personale nga emisioni **"Zonë e Lirë"**, transmetuar në datë 7 shkurt 2025 në MCN TV, ishte evidentuar nga AMA edhe gjatë procesit të monitorimit të përmbajtjeve audiovizive. Pas konsultimit të rastit për mendim të specializuar me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AMA, përmes shkresës nr. 604/2 prot., datë 03.03.2025, i tërhoqi vëmendjen televizionit MCN TV, duke i kërkuar ndërprerjen e praktikave të tilla. Në rast përsëritjeje, AMA paralajmëroi nisjen e procedimit administrativ në zbatim të legjisllacionit në fuqi.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
F.F.	Top Channel	Big Brother Vip Albania	27.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi F.F. paraqiti një ankesë pranë Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt programin **"Big Brother Vip Albania"**, të transmetuar në Top Channel. Ankuesi pretendonte se në emision kishte: **"manipulim të publikut, lejim të bullizmit, dhunës dhe diskriminimit në një program televiziv"**.

Ndaj, ai kërkoi nga Autoriteti i Mediave Audiovizive që:

- të hetoheshin shkeljet e etikës nga produksioni i **Big Brother Vip Albania 4**;
- Top Channel të mbahej përgjegjës për manipulimin e publikut dhe lejimin e bullizmit, dhunës dhe diskriminimit;
- të sigurohej trajtim i barabartë dhe korrekt për të gjithë konkurrentët, pa presione dhe manipulime;
- të merreshin masa konkrete për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen;
- të kërkohet nga prokuroria hetimi i procesit të votimit dhe numërimit.

1. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga objekti i ankesës dhe fusha e veprimtarisë së AMA-s, ankuesit iu bë me dije se:

- Autoriteti i Mediave Audiovizive e ka pasur dhe vazhdon ta ketë nën monitorim formatin audioviziv **"Big Brother Vip Albania 4"**, pjesë e strukturës programore të televizionit "Top Channel" dhe kanaleve të dedikuara **"Big Brother Vip 1"** dhe **"Big Brother Vip 2"** në platformën DigitAlb;
- shkeljet apo shmangiet nga detyrimet e parashikuara në Ligjin nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, dhe në Kodin e Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023 (i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024), janë bërë tashmë objekt i disa vendimmarrjeve të AMA-s, të cilat kanë reflektuar peshën e shkeljeve dhe për pasojë i është tërhequr vëmendja OSHMA-ve (Top Channel

dhe DigitAlb) për shmangiet e konstatuara.

Lidhur me pretendimin e ankuesit sipas të cilit: ***“në një veprim shokues dhe manipulativ, produksioni i Big Brother e detyroi Gjestin të pranonte rikthimin e dy konkurrentëve”***, Këshilli i Ankesave sqaroi se, bazuar në nenin 2 të Ligjit nr. 97/2013, AMA vepron në kuadrin e **transmetimeve audiovizive lineare, jo-lineare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, si dhe shërbimeve të platformave të shpërndarjes së videove**.

Referuar kësaj dispozite, pretendimet që lidhen me marrëdhënie kontraktuale mes produksionit dhe konkurrentëve nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga

AMA, pasi ato dalin jashtë kompetencës ligjore të Autoritetit. Po ashtu, OSHMA nuk ka as detyrim ligjor të depozitojë kontrata të kësaj natyre pranë AMA-s.

Në lidhje me pretendimin se: ***“potentohet të pengohet fitorja e Gjestit duke vendosur atë në situata të pamundura psikologjike dhe emocionale”***, Këshilli theksoi se AMA nuk ka tagër ligjor të ndërhyjë në marrëdhënie që burojnë nga kontrata private mes konkurrentit dhe produksionit televiziv.

Gjithashtu, sa i takon kërkesës për hetimin e procesit të votimit, ankuesit iu shpjegua se **AMA nuk ka kompetencë ligjore për të kërkuar hetim apo për të sugjeruar nisjen e një procesi hetimor mbi këtë element**.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.A.	Abc News	Gjërat tona	12.03.2025

1. 1. Objekti i Ankesës

Shtetasja A.A. i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin **"Gjërat tona"**, të transmetuar në Abc News. Ankuesja pretendonte se në këtë emision ishin transmetuar të dhënat e saj personale, pa pëlqimin e saj.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave konstatoi shmangie nga Ligji nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, si edhe nga Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 228, datë 11.12.2017.

Këshilli vlerësoi se publikimi i të dhënave personale të ankueses dhe djalit të saj, si dhe identifikimi i banesës në pronësi të tyre – të dhëna të marra nga dosja hetimore e një çështjeje në proces – mund të ishin evituar, pasi:

- nuk i shërbenin investigimit, për shkak se nuk ofronin elementë të rinj apo të dobishëm për sqarimin e sfondit të ngjarjes;
- nuk i shërbenin interesit publik, pasi çështja ndodhej në hetim nga organet kompetente;
- përbënin shkelje të dispozitave ligjore dhe të Kodit të Transmetimit, duke cenuar etikën profesionale dhe kodin e deontologjisë së gazetarit, si edhe kuptimin publik të misionit të tij.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i tërhoqi vëmendjen OSHMA-s për shmangie nga Ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, dhe nga Kodi i Transmetimit.

Gjithashtu, OSHMA u paralajmërua se, megjithëse formati në fjalë ka një rol investigues në sensibilizimin e opinionit publik mbi ngjarje dhe dukuri problematike të shoqërisë, përsëritja e shkeljeve të tilla do të sjellë penalizim sipas sanksioneve të parashikuara në Ligjin nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Sh.	TV Klan	Lajme	17.03.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi A.Sh. i paraqiti një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me pretendimin se televizioni **"TV Klan"**, në një edicion informativ, kishte ekspozuar të dhënat e tij personale pa pëlqimin e tij.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive. Nga këqyrja e edicionit informativ, Këshilli konstatoi publikimin e të dhënave personale të ankuesit (gjeneralitetet dhe adresa), konkretisht në minutën 15:46, gjatë transmetimit të një materiali që pasqyronte kthimin e përgjigjes nga Ministria e

Infrastrukturës dhe Energjisë ndaj një kërkesë të paraqitur më parë nga ankuesi.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave vlerësoi se publikimi i të dhënave personale përbënte shkelje të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, si edhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2024. Për këtë arsye, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i tërhoqi vëmendjen OSHMA-s për shmangie nga dispozitat ligjore dhe i kërkoi **heqjen e të dhënave personale nga materiali i transmetuar dhe ndalimin e publikimit të mëtejshëm të tyre.**

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.K.	Syri TV	Piranjat	17.03.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja A.K. i paraqiti një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me pretendimin se emisioni **"Piranjat"**, i transmetuar në "Syri TV", kishte cenuar imazhin e saj dhe kishte shpërndarë informacione të pavërteta, **"pa paraqitur prova dokumentare ose kontekst"**. Ankuesja kërkonte gjithashtu ushtrimin e të drejtës së përgjigjes.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive të emisionit. Nga këqyrja e materialit rezultoi se emisioni kishte natyrë investigative dhe në të ishin pyetur të gjitha palët e përfshira, përfshirë edhe ankuesen, e cila në një intervistë për media kishte deklaruar versionin e saj të ngjarjes.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Bazuar nësa më sipër, Këshilli i Ankesave nuk evidentoi përdorim të fjalorit fyes apo shkelje të etikës së komunikimit gjatë raportimit të rastit. Këshilli gjykoi se publikimi dhe investigimi i ngjarjes i shërbente interesit publik. Informacionet e transmetuara nga stafi i emisionit i referoheshin deklaratave dhe komunikimeve të palëve të përfshira dhe kishin për qëllim zbardhjen dhe trajtimin e drejtë të çështjes.

Në përfundim, referuar Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, dhe Kodit të Transmetimit, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s **nuk konstatoi shkelje të dispozitave ligjore.**

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Z.I	Syri TV	Piranjat	21.03.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi Z.I. i paraqiti një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me pretendimin se në emisionin **"Piranjat"**, të transmetuar në "Syri TV", gazetari kishte shfaqur sjellje jo etike dhe se kishte ndodhur devijim apo spostim i vëmendjes nga zbardhja e së vërtetës. Ankuesi kërkonte gjithashtu ushtrimin e së drejtës së përgjigjes.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive të emisionit. Nga këqyrja rezultoi se materiali kishte natyrë investigative dhe në të ishin pyetur të gjitha palët e përfshira, përfshirë edhe ankuesin, i cili, përmes një interviste, kishte paraqitur versionin e tij të ngjarjes.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli vlerësoi se qasja, trajtimi

dhe interpretimi i fakteve nga ana e formatit dhe e gazetares përbëjnë pjesë të **kompetencës editoriale të medias** dhe të **lirisë profesionale të gazetarit**, të cilat mbrohen nga Ligji nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, sipas të cilit **"veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë"** (neni 4, pika 1/a).

Duke qenë se ankuesi ishte i pranishëm në emision si i intervistuar dhe pati mundësinë të paraqiste versionin e tij, në kuptim të nenit 53, pika 13/ë të Ligjit nr. 97/2013, **"Këshilli i Ankesave mund të refuzojë një ankesë, kur transmetimi i kundërshtuar përmban një thënie apo deklaram të personit të prekur, të tillë që konsiderohet i barasvlerëshëm me vetë përgjigjen e kërkuar..."**.

Për rrjedhojë, në vlerësimin e Këshillit të Ankesave, emisioni **"Piranjat"**, i transmetuar në OSHMA-në "Syri TV", nuk konsiderohet në shkelje për **"refuzim të së drejtës së përgjigjes"**. Kjo, jo vetëm sepse në rastin konkret nuk ekziston e drejta e përgjigjes, por edhe sepse, në përmbushje të kushteve ligjore për ushtrimin e kësaj të drejte, ankuesit i ishte ofruar kohë televizive

dhe mundësia e pranisë/shprehjes në formatin përkatës **"në mënyrë të ngjashme dhe me kohë të njëjtë me atë**

të transmetimit objekt ankese" (Ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, neni 53, pika 10).

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.K.	Syri TV	Piranjat	01.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi A.K. i paraqiti një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin **"Piranja"**, i transmetuar më datë 14.03.2025, ora 20:45.

2. Administrimi i Ankesës

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoirastin, ku pretendohet se **"në emisionin e sipërpërmendur u transmetuan deklaratat që cenonin dinjitetin personal të ankuesit dhe mund t'i shkaktonin dëm kompanisë**

Aplus Medical". Gjithashtu, shtetasi A.K. pretendonte se gazetarja kishte përdorur ndaj tij termin **"mashtrues"**, si edhe se ishin shpërndarë informacione të pavërteta.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive konstatoi se nuk rezultonte shkelje e Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, dhe as e Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
Z.I.	Syri TV	Piranjat	01.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave mori në shqyrtim ankesën e shtetasit Z.I., i cili iu drejtua Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt: ***"Ankesë për sjellje jashtë etikës së gazetarit dhe ligjit, si dhe devijim e spostim të vëmendjes nga dalja e së vërtetës"***.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave administroi rastin dhe nuk evidentoi shkelje të etikës profesionale apo spostim të vëmendjes nga zbardhja e së vërtetës. Këshilli konstatoi se trajtimi dhe interpretimi i fakteve nga ana e formatit televiziv dhe gazetares përbëjnë pjesë të

kompetencës editoriale të medias dhe të lirisë profesionale të gazetarit, të cilat mbrohen nga Ligji nr. 97/2013 ***"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"***, i ndryshuar, sipas të cilit: ***"veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë"*** (neni 4, pika 1/a).

Për rrjedhojë, në vlerësimin e Këshillit të Ankesave, emisioni ***"Piranjat"***, i transmetuar në OSHMA-në "Syri TV", nuk konsiderohet në shkelje për ***"refuzim të së drejtës së përgjigjes"***. Kjo, jo vetëm sepse për rastin konkret nuk kishte vend ushtrimi i kësaj të drejte, por edhe sepse, në kuptimin e nenit 53, pika 10 të Ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, subjekti ankimues është vënë në dispozicion me ***kohë televizive dhe mundësinë e pranisë/shprehjes*** në formatin përkatës, në mënyrë të ngjashme dhe me kohë të njëjtë me atë të transmetimit që ishte objekt i ankesës.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.A.	Abc News	Gjërat tona	02.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasja A.A. i paraqiti një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin **"Gjërat tona"**, të transmetuar më datë 09.03.2025 në Abc News. Ankuesja pretendonte se **"në emisionin në fjalë është cenuar dinjteti dhe privatësia e saj dhe e djalit të saj, përmes publikimit të gjeneraliteteve dhe të pronës së tyre të dhënë me qira"**.

2. Administrimi i Ankesës

Pas shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave konstatoi shkelje të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, si edhe të Kodit

të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 228, datë 11.12.2017.

Këshilli vlerësoi se publikimi i të dhënave personale të ankueses dhe të djalit të saj, si edhe identifikimi i banesës në pronësi të tyre, **nuk i shërbenin investigimit dhe as interesit publik**, përkundrazi përbënin shkelje të dispozitave ligjore dhe etike të sipërcituara.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i tërhoqi vëmendjen emisionit **"Gjërat tona"** në Abc News dhe i kërkoi respektimin e dispozitave ligjore dhe të Kodit të Transmetimit në të ardhmen.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
A.S. - E.P. - T.P. - K.S.	Top Channel	Big Brother Vip Albania	06.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave shqyrtoi ankesat e shtetasve A.S., E.P., T.P. dhe K.S., me objekt përmbajtjen e emisionit **"Big Brother Vip Albania"**, të transmetuar në Top Channel më datë 05.04.2025.

Ankuesit pretendonin se konkurrenti Laert Vasili kishte përdorur në program një shprehje fyese, e cila ofendonte besimtarët myslimanë.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit, Këshilli i Ankesave konstatoi se përmbajtja e transmetuar përbënte shkelje të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në**

Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si edhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 228, datë 11.12.2017.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, për shkak të audiencës së lartë, e ka pasur nën monitorim me prioritet formatin audioviziv **"Big Brother Vip Albania 4"**, pjesë e strukturës programore të

televizionit "Top Channel" dhe të kanaleve të dedikuara **"Big Brother Vip 1"** dhe **"Big Brother Vip 2"** në DigitAlb.

Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s propozoi vendosjen e sanksionit me gjobë ndaj subjektit audioviziv "DigitAlb". Ky propozim u miratua nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.Ch.	Top Channel	Big Brother Vip Albania	08.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim një ankesë me objekt përmbajtjen e programit **"Big Brother Albania"**. Shtetasi E.Ch. pretendonte se njëri prej konkurrentëve në program po ushtronte dhunë verbale ndaj konkurrentëve të tjerë.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës së shtetasit E.Ch., Këshilli i Ankesave pranë AMA-s shqyrtoi me vëmendje përmbajtjen audiovizive të referuar dhe evidentoi se ndërmjet banorëve ishte zhvilluar një lojë me karakter argëtues, e cila nuk kishte synim të fyente ndonjërin prej tyre, por ishte realizuar në kontekstin e lojës.

Sa i përket pretendimit të ankuesit se **"kur të tjerët janë prekur me duar apo me fjalë, kanë dalë me zarf të zi"** dhe **"Xhestin, veç për disa 'like' e lejojnë"**, Këshilli theksoi se, bazuar në nenin

2 të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, këto pretendime nuk janë objekt shqyrtimi nga AMA.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në cilësinë e autoritetit rregullator, ushtron kompetencat e tij vetëm **"për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove"**.

Referuar kësaj dispozite ligjore, shqyrtimi i pretendimeve që lidhen me konceptin editorial, mënyrën e zhvillimit apo linjën programore të formateve televizive si **"Big Brother"** del jashtë tagrit të AMA-s. Kompetencat e Autoritetit fillojnë vetëm aty ku përmbajtja e transmetuar cenon dispozitat e parashikuara nga Ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, dhe nga **Kodi i Transmetimit**, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2024.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Dhjetëra ankues	Top Channel	Big Brother Vip Albania	14.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim dhjetëra ankesa të mbërritura në institucion, me objekt emisionin **"Big Brother Vip Albania 4"**, të transmetuar në Top Channel, ku pretendohet **"transmetim i pamjeve të dhunshme"**. Në këto ankesa shprehet shqetësimi për pasojat e transmetimit të këtyre përmbajtjeve dhe kërkohej marrja e masave nga Autoriteti.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesave, Këshilli i Ankesave shqyrtoi emisionin **"Big Brother Vip Albania 4"**, të transmetuar në Top Channel dhe në kanalet e dedikuara **"Big Brother Vip 1"** dhe **"Big Brother Vip 2"** në DigitAlb. Nga këqyrja u konstatua se më datë 13 prill 2025, ora 00:30:20, njëri prej pjesëmarrësve në emision, Jozef Marku, kishte goditur me shpullë konkurrentin Besart Kelmendi (i njohur si Gjesti).

Menjëherë pas incidentit, produksioni i formatit televiziv dhe subjekti audioviziv **"Top Channel"**

ndërmorën një sërë veprimesh të menjëhershme dhe të dokumentuara, përfshirë:

- reagimin live gjatë transmetimit;
- distancimin nga akti i dhunës brenda formatit;
- përjashtimin e menjëhershëm të konkurrentit nga gara;
- publikimin e një deklarate zyrtare, ku dënohej akti dhe garantohehin masa përmbrojtjeje pjesëmarrësve;
- depozitimin e një kallëzimi pranë organeve kompetente (polici/prokurori) për ndjekjen penale të ngjarjes.

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave mbajti parasysh faktin se këto masa përfaqësonin një reagim të menjëhershëm dhe proaktiv, në përputhje me përgjegjësitë editoriale dhe ligjore të ofruesit të shërbimit audioviziv, siç parashikohen nga Ligji nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
P.A.	Euro News Albania	Lajme	13.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim një ankesë nga shtetasi P.A., i cili pretendonte se media kishte ngatërruar identitetin e tij, duke e asociuar me autorin e një ngjarjeje të rëndë kriminale.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Administrimi i ankesës nga Këshilli

i Ankesave pranë AMA-s u krye në përputhje me Ligjin nr. 97/2013 ***"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"***, i ndryshuar, konkretisht nenin 2 ***"Fusha e zbatimit"***. Sipas kësaj dispozite: ***"Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre"***.

Në këtë kuadër, u sqarua se **mediat online dhe portalet nuk përfshihen në juridiksionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive** dhe, për pasojë, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga Këshilli i Ankesave.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Sh.B.	Report TV	"Pa Gjurmë"	24.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë nga znj. Sh.B., me objekt emisionin **"Pa Gjurmë"**, të transmetuar në Report TV.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur, Këshilli i Ankesave evidentoi se redaksia e emisionit **"Pa Gjurmë"** në Report TV kishte ndërmarrë veprimet përkatëse, duke hequr materialet e transmetuara nga platforma **YouTube**.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
T.Th	Tring	Ferma VIP	24.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi T.Th. paraqiti një ankesë pranë Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin **"Ferma Vip"**, të transmetuar në Vizion Plus dhe në dy kanalet e dedikuara në platformën Tring, **"Ferma Vip 1"** dhe **"Ferma Vip 2"**. Ankuesi pretendonte se në këtë program audioviziv ishte përdorur **"gjuhë seksiste në dëm të disa banorëve"**.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nisur nga shqyrtimi i çështjes, si edhe duke pasur parasysh se:

- **"Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive"**,
- **"Detyrimet e OSHMA-ve" dhe**
- **"Rregullat e përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike**

audio dhe/ose audiovizive"

zbatohen njësoj edhe për transmetimet sipas kërkesës së përdoruesit (me pagesë), pavarësisht fashës orare,

Këshilli i Ankesave, bazuar në **"Rregulloren për shqyrtimin e ankesës nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtën e përgjigjes"**, të ndryshuar me vendimin e AMA-s nr. 56, datë 07.07.2023, neni 6 **"Konkluzionet e Këshillit të Ankesave"**, pika 4, vendosi të tërheqë vëmendjen e subjektit për shmangie nga:

- Ligji nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, dhe
- Kodi i Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023 (i ndryshuar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024).

Gjithashtu, subjektit iu rikujtua se përsëritja e shkeljeve të ngjashme do të trajtohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
FSHDKPAK	Top Channel	"Fiks Fare"	01.05.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara me objekt një material të publikuar në emisionin "Fiks Fare" në Top Channel për kandidatin për deputet G.S

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ku pretendohet se janë publikuar të dhëna sensitive të shtetasit G. S, kandidat për deputet.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim të administrimit të të gjithë informacionit në dispozicion, përfshirë pretendimet e subjektit, Këshilli i Ankesave, konstatoi se shkelja parësore u takon institucioneve, që kanë lejuar përpunimin e të dhënave sensitive në shpërfillje të dispozitave përkatëse (Ligji nr. 24/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale), Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), i tërhoqi vëmendjen subjektit audioviziv, TOP Channel për mënyrën e trajtimit të çështjes dhe i kërkoi ndalimin e ritransmetimit të emisionit përkatës, në formën aktuale dhe heqjen e videos përkatëse nga faqja zyrtare e Top Channel dhe llogaritë e tij në platformat e shpërndarjes së videove.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
H.J.	TV Klan	Stop	30.05.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit H.J., i cili pretendonte se i ishte cenuar privatësia nga emisioni **"Stop"**, i transmetuar në TV Klan.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave administroi ankesën

e paraqitur nga shtetasi H.J., i cili pretendonte se emisioni **"Stop"** kishte cenuar privatësinë e tij. Pas verifikimit të materialit, Këshilli konstatoi se emisioni nuk përmbante asnjë element që të identifikonte subjektin në kuptim të Ligjit organik të AMA-s.

Për rrjedhojë, nuk u përmbush kriteri ligjor për të filluar një shqyrtim të thelluar mbi shkeljen e jetës private apo të etikës mediatike, siç përcaktohet në nenin 33 të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.C.	Viziion Plus	7 pa 5	04.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit A.C., i cili pretendonte se në program ishin publikuar të pavërteta. Ai kërkonte që video e programit të hiqej nga platforma **YouTube** dhe që përmbajtja të përgënjeshtrohej publikisht.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave shqyrtoi ankesën e shtetasit A.C., me objekt emisionin **"7pa5"**, i transmetuar në televizionin **"Vizion Plus"** më datë 07.05.2025, ora 08:30.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës dhe të

pretendimeve të paraqitura nga OSHMA, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankuesit i lind e drejta për ushtrimin e **"të drejtës së përgjigjes"** sipas nenit 53 të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, në televizionin **"Vizion Plus"**.

Me shkresën nr. 1658/2 prot., datë 16.06.2025, OSHMA iu përgjigj **"Kërkesës për paraqitje pretendimesh"**, të dërguar nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, duke sqaruar se:

"Qëllimi kryesor i programit ka qenë në çdo rast ndihmesa ndaj teleshikuesve në lidhje me gjetjen e zgjidhjeve për problematikat e tyre dhe në asnjë rast programi nuk ka pasur synim cenimin e figurës së z. A.C. Njëkohësisht, jemi të hapur që ankuesi z. A.C., me dëshirën dhe vullnetin e tij të plotë, të paraqitet pranë Vizion Plus, për të deklaruar pretendimet e tij ose për të përgënjeshtruar pretendimet e znj. O.C."

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.M.	Syri TV	Piranjat	05.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e znj. D.M., me objekt **"keqpërdorimin e figurës"** nga emisioni **"Piranja"**, i transmetuar në televizionin **"Syri TV"**.

2. Administrimi i Ankesës

Autoriteti i Mediave Audiovizive, bazuar në Ligjin nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, konstatoi se më datë 23.05.2025, gjatë emisionit **"Piranja"**, nuk ishin respektuar kërkesat ligjore në fuqi.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli evidentoi se në përmbajtjen e transmetuar ishte përdorur fjalor joetik dhe shumë agresiv, duke përfshirë fyerje dhe sharje denigruese, të cilat buronin nga dialogë të shkëputur nga rrjeti social **"TikTok"**.

Gjithashtu, u konstatua se transmetimi dhe ritransmetimi i kësaj pjese të emisionit përkonte me fashën orare kur para ekranit mund të ishin edhe fëmijët, çka përbënte një cënim të detyrimeve ligjore për mbrojtjen e audiencës së mitur.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i tërhoqi vëmendjen emisionit **"Piranja"** në **Syri TV** dhe kërkoi ndërprerjen e praktikave të tilla. Gjithashtu, u paralajmërua se në rast të përsëritjes së shkeljeve të ngjashme, do të nisë procedimi administrativ në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.M.	Report TV	"Pa Gjurmë"	09.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetases A.M., me objekt emisionin **"Pa Gjurmë"**, të transmetuar në televizionin **"Report TV"**. Në ankesë pretendohet se emisioni kishte intervistuar shtetasin Y.M., i cili, sipas ankuses, kishte dhënë deklaratatë të paqarta dhe të pasakta, në përputhje me simptomat e gjendjes së tij mendore.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të kësaj

ankese, Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-së **"Report TV"** paraqitjen e pretendimeve lidhur me çështjen e sipërcituar.

1. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës së shtetases A.M. dhe të pretendimeve të paraqitura nga OSHMA **"Report TV"**, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s konstatoi se në këtë rast lind e drejta për ushtrimin e **"të drejtës së përgjigjes"**, në përputhje me nenin 53 të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
E.Z.	Top Channel	-	18.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e znj. E.Z., mbërritur në institucion me objekt përdorimin nga media të një fotografie pa pëlqimin e saj.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e znj. E.Z., e cila pretendonte se televizioni **"Top Channel"** kishte publikuar një lajm në lidhje me çështjen e shtetasit F.M., dhe se në përmbajtjen e këtij lajmi ishte përdorur **"një fotografi e marrë nga profili i Facebook-ut të vëllait të ankueses, ku shfaqej edhe ankuesja, pa dakordësinë apo autorizimin e saj"**.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave i kërkoi Bordit të Shqyrtimit të Ankesave pranë

OSHMA-së **"Top Channel"** paraqitjen e pretendimeve dhe sqarimeve lidhur me çështjen e ngritur. Në përgjigjen e saj, OSHMA bëri me dije se:

"Shoqëria Top Channel sh.a, në zbatim të nenit 51 të Ligjit nr. 97/2013 'Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar, si dhe në bazë të rregullores së miratuar 'Për procedurat dhe trajtimin e ankesave pranë Top Channel', ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke hequr fragmentin (fotografinë e cituar) nga materiali filmik i publikuar në linkun: <https://top-channel.tv/video/top-channel-kapet-me-arme-dhe-droge-i-rrezikshmi-i-pogradecit-mucollari-eliminoni-bashkemoshatarin/>".

Në përfundim, u konstatua se OSHMA kishte reaguar në mënyrë të menjëhershme, duke ndërmarrë veprimet dhe korrigjimet e nevojshme në përmbajtjen audiovizive. Për rrjedhojë, Këshilli i Ankesave e konsideron të mbyllur trajtimin e kësaj ankesë, duke ju falënderuar për besimin e treguar ndaj institucionit tonë rregullator.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Gj. Sh.	MCV TV	Fol	30.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti ankesa e znj. R.G., me objekt emisionin **"Fol"**, të transmetuar në MCN TV.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave në AMA administroi gjithashtu ankesën e z. Gj.Sh., i cili pretendonte se gjatë transmetimit të emisionit **"Fol"** në MCN TV, më datë 13.06.2025, ishin përfshirë përmbajtje të pavërteta, shpifje, fyerje, nxitje dhune dhe kërcënime me jetë kundër tij.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kuadër të administrimit të ankesës së z. Gj.Sh., Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen audiovizive dhe evidentoi se:

- Emisioni **"Fol"**, i transmetuar në MCN TV më 13 qershor 2025, trajtonte një konflikt pronësie të pazgjidhur, i cili është ende në

shqyrtim nga organet e drejtësisë.

- Në studio ishin të pranishëm banorë të godinës dhe një prej pretenduesve të pronësisë, të cilët, përmes diskutimit me gazetarin, ndanin përjetimet dhe qëndrimet e tyre për situatën.
- Gjatë emisionit, debati përshkallëzohej disa herë dhe, ndonëse disa prej banorëve përdorën shprehje denigruese dhe kërcënuese në adresë të individit në konflikt, gazetari ndërhyri vetëm në një rast, për të qetësuar tonet dhe për të shmangur gjuhën fyese.
- Në mbyllje të emisionit, gazetari pranoi se çështja mbetej e ndërlikuar, me dokumentacion të shumtë dhe pa një zgjidhje të qartë institucionale.

Pas vlerësimit të përmbajtjes audiovizive, Këshilli i Ankesave çmoi se kjo mënyrë e menaxhimit të debatit përbënte shmangie nga:

- **Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar (neni 4, pika 2/dh dhe neni 46, pika 2/c), si edhe

- **Kodi i Transmetimit**, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023, i amenduar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024 (Seksioni 3, pika 3.9 dhe Seksioni 5, pika 5.31).

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së për mënyrën e trajtimit të

çështjes dhe i kërkoi njëkohësisht:

- ndalimin e ritransmetimit të emisionit përkatës në formën aktuale;
- heqjen e fragmenteve përkatëse nga faqja zyrtare e MCN TV dhe nga llogaritë e tij në platformat e shpërndarjes së videove.

2

Ankesa me objekt

"cenimin e të drejtave

të fëmijëve"

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.T.	Top Channel	"Big Brother Vip Albania"	01.01.2025

1. 1. Objekti i Ankesës

Shtetasi D.T. paraqiti një ankesë pranë Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me pretendimin se emisioni **"Big Brother Vip Albania 4"**, i transmetuar në orën 21:00, ishte i papërshtatshëm. Në ankesë argumentohej se **"në atë fashë orare fëmijët mund të shikojnë televizion... reklamohen persona që deklarohen homoseksualë dhe mbi të gjitha shpallen si heronj në televizione"**.

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen

audiovizive të emisionit. Nga këqyrja e materialit rezultoi se diskutimi i zhvilluar në program nuk kishte për qëllim promovimin apo reklamimin e çështjes së përmendur nga ankuesi, por përbënte një debat me pikëpamje të ndryshme të të ftuarve në studio.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës dhe përmbajtjes përkatëse, Këshilli i Ankesave konstatoi se nuk kishte shkelje të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
I.M.	Top Channel	E Diell	23.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi I.M. paraqiti një ankesë pranë Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku shprehte shqetësimin se në emisionin **"E Diell"**, **"në mes të drekës, në një orar që mund të ndiqet edhe nga fëmijët, promovohet OnlyFans dhe prostitucioni"**.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen e rubrikës **"Trotuar"** të emisionit **"E Diell"**, të transmetuar në televizionin **"Top Channel"** më datë 19.01.2025, ora 16:00.

Nga këqyrja e materialit u evidentua se:

- gjatë debatit në studio u diskutua nga këndvështrime të ndryshme mbi platformën **"OnlyFans"**, duke u trajtuar si një hapësirë ku **"monetizohet ekspozimi trupor"**, perceptimi shoqëror i saj (si "platformë kreativiteti", "mundësi për pavarësi financiare", "provokim për normat shoqërore"), karakteri

i nudizmit që ofrohet në të ("art apo biznes"), shkaqet dhe motivet sociale që shtyjnë përdoruesit drejt saj, modelet që nxit dhe pasojat shoqërore që prodhon.

- shtjellimi i temës, veçanërisht përmes ballafaqimit të pikëpamjeve të ndryshme dhe shpesh të kundërta, u vlerësua se kishte interes të gjerë shoqëror dhe i shërbente informimit të publikut mbi dukurinë dhe pasojat e saj.

Megjithatë, Këshilli vuri në dukje se rubrika në fjalë ishte pjesë e një programi me karakter familjar, të ndjekur nga të gjitha grupmoshat dhe i prezantuar si **"program argëtues, informues dhe edukativ, me rubrika të dedikuara për fëmijët, të rriturit dhe të gjithë familjen"**. Ajo u transmetua në fashën orare 16:10–16:40, menjëherë pas rubrikës për fëmijë **"Diellorët"**, duke qenë e ndarë vetëm me një hapësirë publicitare. Për më tepër, mungonte çdo paralajmërim grafik, akustik apo verbal nga drejtuesja e rubrikës për përmbajtjen e mëtejshme.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, në vendimmarrjen e tij, gjykoj se mënyra e transmetimit të rubrikës përbënte shmangie nga detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Transmetimit.

Ekspozimi i fëmijëve ndaj informacionit për të rritur, pa mjetet e duhura mbrojtëse dhe jashtë një konteksti edukativ të përshtatur, rrezikon të sjellë:

- perceptim të gabuar të dukurisë nga fëmijët,
- nxitjen e një interesi të pavend për platformën,
- heqjen e barrierave për abuzimin e mundshëm nga të tretët.

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së për zbatimin rigoroz të detyrimeve ligjore dhe të Kodit të Transmetimit, duke kërkuar shmangien e përsëritjes së rasteve të ngjashme.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
L.B.	You Tube	Video	30.02.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi L.B. paraqiti një ankesë pranë Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në lidhje me disa video të publikuara në platformat **YouTube** dhe **Instagram**, duke pretenduar se përmbajtjet ishin të papërshtatshme për fëmijët.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në administrimin e ankesës, Këshilli

i Ankesave u mbështet në Ligjin nr. 97/2013 **“Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”**, i ndryshuar. Neni 2 i këtij ligji parashikon se AMA, si autoritet rregullator, ushtron kompetencë mbi veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose të PSV-ve.

Megjithatë, për shkak të mungesës së një përfaqësimi zyrtar dhe regjistrimi të platformës **YouTube** në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka juridiksion mbi këtë platformë. I njëjti parim zbatohet edhe për platforma të tjera ndërkombëtare që nuk kanë përfaqësim ligjor në vend.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
ODFR	Syri TV	Piranjat	03.03.2025

1. Objekti i Ankesës

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve paraqiti një ankesë pranë Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin **"Piranjat"**, të transmetuar në **"Syri TV"** më datë 28 shkurt 2025, ora 21:15. Sipas Observatorit, emisioni kishte publikuar **"pamje dhe video të një vajze të mitur 16-vjeçare, me aftësi të kufizuara, e cila ishte**

viktimë e përdhunimit të vazhdueshëm nga bashkëjetuesi i nënës së saj".

2. Administrimi i Ankesës

Gjatë administrimit të ankesës, ankuesi u informua se nga shqyrtimi i materialit audioviziv Këshilli i Ankesave evidentoi se intervistimi i fëmijës–viktimë e abuzimit seksual ishte realizuar në

përputhje me parimin e **interesit më të lartë të fëmijës**, siç parashikohet në pikën 4.24 të Kodit të Transmetimit.

Gjithashtu, gjatë transmetimit të intervistës ishte përdorur teknikë e posaçme për mbrojtjen e identitetit, ndërkohë që nuk ishin publikuar inicialet e emrit dhe mbiemrit të fëmijës.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave vlerësoi se raportimi i çështjeve që lidhen me fëmijët dhe të drejtat e tyre duhet të udhëhiqet gjithmonë nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, i cili prevalon mbi çdo interes tjetër. Në këtë kuadër, Autoriteti i Mediave Audiovizive konstatoi se përmbajtja e transmetuar ishte në përputhje me dispozitat ligjore dhe me Kodin e Transmetimit.

3

Ankesa jashtë

juridiksionit

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.ZH.	You Tube	Video	16.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi M.Zh. i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt një **"video denigruese me përmbajtje seksuale, fyese dhe**

shpifëse". Ankuesi pretendonte se videoja ishte ngarkuar në platformën **YouTube** tre vite më parë dhe kërkonte nga AMA marrjen e masave për fshirjen ose heqjen e saj.

2. Administrimi i Ankesës

Gjatë administrimit të kësaj ankese, ankuesit iu bë me dije se:

- videoja në fjalë ishte ngarkuar në **YouTube** tre vite më parë dhe kërkesa për heqjen e saj i drejtohej Autoritetit të Mediave Audiovizive;
- sipas Ligjit nr. 97/2013 **"Për**

mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (edhe me Ligjin nr. 30/2023), neni 2 përcakton se AMA, si autoritet rregullator, ushtron kompetencë mbi veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose PSV-ve;

- megjithatë, në kushtet e mungesës së një përfaqësie dhe regjistrimi të platformës

YouTube në Republikën e Shqipërisë, AMA nuk ka juridiksion për të vepruar mbi të.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim, ankuesit iu bë e qartë se, për shkak të mungesës së një përfaqësie të **YouTube** në Shqipëri, Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka kompetencë ligjore për të ndërhyrë apo për të kërkuar fshirjen e përmbajtjes së publikuar në këtë platformë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
J.C.	JOQ	Lajm	27.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e znj. J.C., lidhur me publikimin e një shkrimi në portalin **"JOQ Albania"**. Sipas ankueses, në artikull denoncohej një produkt, brenda të cilit pretendohet se ishin gjetur copa xhami, pretendime që sipas saj përbënin lajm të rremë, me qëllim dëmtimin e imazhit të biznesit.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, ankueses iu bë me dije se, në bazë

të dispozitave të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, të ndryshuar, neni 2 **"Fusha e zbatimit"** përcakton se ky ligj zbatohet për:

- transmetimet e mediave audiovizive lineare,
- transmetimet audiovizive jolineare,
- shërbimet mbështetëse të tyre.

Mediat online dhe portalet nuk përfshihen në këtë fushë rregullimi dhe, rrjedhimisht, janë jashtë juridiksionit të AMA-s. Për këtë arsye, ankuesja u informua se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka tagër ligjor për të ndërhyrë ndaj përmbajtjeve të publikuara në portalet online.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Av.G.K	Elbasani Flash	Lajm	16.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e Av. G.K., lidhur me publikimin e një shkrimi në portalin **"Elbasani Flash"**. Sipas ankuesit, lajmi përmbante **"të dhëna personale, si dhe etiketime fyese e shpifëse, me qëllim të vetëm denigrimit e figurës së tij dhe të profesionit që ushtronte prej mbi 23 vitesh"**.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, ankuesit iu bë me dije se, në bazë të

dispozitave të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, të ndryshuar, neni 2 **"Fusha e zbatimit"** përcakton se ky ligj zbatohet për:

- transmetimet e mediave audiovizive lineare,
- transmetimet audiovizive jolineare,
- shërbimet mbështetëse të tyre.

Mediat online dhe portalet nuk përfshihen në këtë fushë rregullimi dhe, për rrjedhojë, janë jashtë juridiksionit të AMA-s.

Në këtë kuadër, ankuesi u informua se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka tagër ligjor për të ndërhyrë ndaj përmbajtjeve të publikuara në portalet online.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
L.B.	Pamfleti Sprint BotaSot LaberiaNews Europaelire Kosova.info	Shkrim	06.02.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë nga znj. L.B. Ankuesja pretendonte se disa shkrime të publikuara në portalet **"Pamfleti", "Sprint", "BotaSot", "LaberiaNews", "Europa e Lirë", "Kosova.info"**, përmbanin informacion të nxjerrë jashtë kontekstit dhe të manipuluar, duke i dëmtuar integritetin profesional dhe personal. Po kështu, sipas saj, **"publikimi është bërë pa miratimin tim, pa verifikim të saktë të deklaratave, me qëllim sensacional dhe përfitimi nga klikimet"**.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i ankesës, Këshilli i Ankesave evidentoi se publikimet për

të cilat ankoheshin kishin ndodhur në portale dhe media online. Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, neni 2 **"Fusha e zbatimit"** përcakton se ky ligj zbatohet për:

- transmetimet audiovizive lineare,
- transmetimet audiovizive jolineare,
- shërbimet mbështetëse të tyre,
- si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove.

Po ashtu, ligji përcakton shprehimisht se **nuk zbatohet për median e shkruar**.

Në këtë kuadër, u konstatua se portalet dhe mediat online vijojnë të jenë jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe për rrjedhojë AMA nuk ka tagër ligjor për të ndërhyrë në rastin e paraqitur.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
E.M.	Alpenews Afapress Pressreader Prapaskena Realstory Ditar Newszone	Shkrim	-

1. Objekti i Ankesës

Shtetësja E.M. paraqiti një ankesë pranë Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me pretendimin se portalet **"Alpenews"**, **"Afapress"**, **"Pressreader"**, **"Prapaskena"**, **"Realstory"** dhe **"Ditar"** kishin publikuar në shkrimet e tyre të dhëna personale të fëmijëve. Në këtë kuadër, ankuesja kërkoi marrjen e masave për fshirjen e tyre.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Nga shqyrtimi i ankesës rezultoi se publikimet e përmendura ishin bërë në portale dhe media online. Bazuar

në dispozitat e Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, neni 2 **"Fusha e zbatimit"** përcakton se ky ligj zbatohet për:

- transmetimet audiovizive lineare,
- transmetimet audiovizive jolineare,
- shërbimet mbështetëse të tyre,
- si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove.

Po ashtu, ligji përcakton shprehimisht se **nuk zbatohet për median e shkruar.**

Në këtë kuadër, Këshilli i Ankesave konstatoi se portalet dhe mediat online nuk bien nën juridiksionin e AMA-s dhe se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka tagër ligjor për të ndërhyrë në rastin e paraqitur.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.J.	Portale	Shkrim	18.02.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetësja M.J. paraqiti një ankesë pranë Këshillit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), duke pretenduar se disa portale kishin publikuar artikuj të cilët, sipas saj, pengonin daljen në pah të së vërtetës lidhur me një ngjarje të ndodhur në subjektin e saj tregtar.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli

i Ankesave evidentoi se materialet e përmendura ishin publikuar në portale dhe media online. Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 97/2013 ***"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"***, i ndryshuar, konstatohet se mediat online dhe portalet nuk përfshihen në juridiksionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Për këtë arsye, ankueses iu bë me dije se AMA nuk ka tagër ligjor për të ndërhyrë apo për të marrë masa ndaj përmbajtjeve të publikuara në portale online.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Sh.	Andale	Foto	27.02.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi A.Sh., lidhur me publikimin e disa pamjeve të fëmijëve në portalin **"Andale"**. Ankuesi kërkonte që të bllokohej dhe të hiqej nga rrjeti një video, ku shfaqej një vajzë e mitur gjatë një reportazhi të publikuar në këtë portal.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli

i Ankesave konstatoi se materiali në fjalë ishte publikuar në një portal online. Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në**

Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, fushëveprimi i këtij ligji shtrihet mbi transmetimet audiovizive lineare, transmetimet jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, por **nuk përfshin mediat online dhe portalet.**

Për këtë arsye, ankuesit iu bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka tagër ligjor për të ndërhyrë apo për të marrë masa ndaj përmbajtjeve të publikuara në portale online.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
S.P.	You Tube	Odeta Dume Live	10.03.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasja S.P., lidhur me kanalin zyrtar të Odeta Dume Mandro, të publikuar në platformën e shpërndarjes së videove **YouTube**. Ankuesja pretendonte se ishte publikuar informacion personal pa lejen e saj, duke cënuar jetën private.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se materialet e

përmendura ishin publikuar në portale online dhe në platformën **YouTube**.

- Sa i përket mediave online, Ligji nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, nuk i jep AMA-s kompetencë ligjore për të ndërhyrë.
- Ndërsa, për rastin e platformës **YouTube**, për shkak të mungesës së një përfaqësie zyrtare dhe regjistrimi të saj në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka juridiksion për të vepruar mbi përmbajtjet e publikuara aty.

Në këtë kuadër, ankueses iu bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka mundësi ligjore për të shqyrtuar më tej ankesën e paraqitur.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.K.	YouTube	Odetta Dume Live	11.03.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi R.K., lidhur me kanalin zyrtar të Odetta Dume Mandro, të publikuar në platformën e shpërndarjes së videove **YouTube**. Ankuesi pretendonte se videot përmbanin "denigrim dhe prishje imazhi" dhe kërkonte nga AMA ndërhyrjen për heqjen e materialit nga kjo platformë.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se materialet e

përmendura ishin publikuar në portale online dhe në platformën **YouTube**.

- Për sa i përket portaleve dhe mediave online, Ligji nr. 97/2013 "**Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë**", i ndryshuar, nuk i jep AMA-s kompetencë ligjore për të ndërhyrë.
- Për rastin e **YouTube**, për shkak të mungesës së një përfaqësie dhe regjistrimi zyrtar të saj në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka juridiksion për të vepruar mbi përmbajtjet e publikuara aty.

Në këtë kuadër, ankuesit iu bë me dije se AMA nuk ka tagër ligjor për të shqyrtuar më tej ankesën dhe për të ndërhyrë në heqjen e materialeve nga platforma **YouTube**.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
O.Xh.	You Tube	Video	18.03.2025

1. Objekti i Ankesës

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri dhe znj. O.Xh. i drejtuan një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në lidhje me një deklaratë të publikuar gjatë një emisioni në platformën **YouTube**. Sipas ankesës, ***“shpërndarja e vetëdijshme e kësaj lloj përmbajtjeje mbart rrezikun për nxitjen e dhunës seksuale ndaj vajzave dhe grave”***.

2. Administrimi i Ankesës

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave sqaroi se:

- Videoja ishte ngarkuar në platformën **YouTube** rreth tre vite më parë.
- Referuar Ligjit nr. 97/2013 ***“Për***

mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (edhe me Ligjin nr. 30/2023), neni 2 i tij i jep AMA-s kompetencë rregullatore mbi veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose PSV-ve.

- Megjithatë, për shkak të mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi zyrtar të platformës **YouTube** në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka juridiksion për të vepruar mbi përmbajtjet e publikuara aty.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në përfundim, ankuesve iu bë me dije se Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk ka mundësi ligjore për të ndërhyrë mbi përmbajtjet e publikuara në platformën e shpërndarjes së videove **YouTube**.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
O.J.	Mediet		31.03.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e shtetasit O.J., i cili pretendonte për "volumin e lartë të reklamave në televizione".

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave e informoi shtetasin O.J. se kjo çështje nuk mund të jetë objekt

shqyrtimi, pasi del jashtë tagrit të AMA-s. Kompetencat e Autoritetit lidhen me mbikëqyrjen e përmbajtjes, respektimin e etikës dhe standardeve editoriale të programeve audiovizive, ndërsa parametrat teknikë të transmetimit, përfshirë edhe volumin, përcaktohen nga vetë operatorët e transmetimit.

Në përfundim, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
Mjekët e Spitalit Psikiatrit Vlorë		JOQ	30.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga mjekët e Spitalit Psikiatrik të Vlorës, me objekt portalin **"Jeta është Qejf"**, në të cilin pretendohet se ishte publikuar një shpifje në adresë të drejtuesve dhe mjekëve të këtij institucioni shëndetësor.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e mjekëve të Spitalit Psikiatrik të Vlorës, të cilët pretendonin se portali **"Jeta është Qejf"** kishte publikuar një

lajm të pavërtetë dhe denigrues ndaj tyre.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave informoi palën ankuese se, sipas kuadrit ligjor aktual, mediat online dhe portalet vijojnë të mbeten jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ky qëndrim mbështetet në ndryshimet e fundit ligjore, të miratuara me Ligjin nr. 30/2023 **"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013 'Për mediat audiovizive në**

Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar", ku kompetencat e AMA-s nuk shtrihen mbi portale dhe mediat online.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.C.		Tik tok	02.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e shtetasit M.C., i cili pretendonte se një video e marrë nga platforma **TikTok** ishte shpërndarë më pas në platformën **Instagram**, duke u nxjerrë nga konteksti.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave informoi ankuesin se, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 06.03.2025, i cili ndalon aksesin zyrtar në platformën **TikTok** në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka mundësi institucionale për të monitoruar, ndjekur ose raportuar mbi përmbajtjet e publikuara në këtë platformë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.K.	Media		07.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e shtetasit A.K., me objekt "volumin e lartë të reklamave në televizione".

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave e informoi ankuesin se kjo çështje nuk mund të jetë objekt

shqyrtimi, pasi del jashtë tagrit të AMA-s. Kompetencat e Autoritetit, - u sqarua, - lidhen me përmbajtjen, etikën dhe standardet editoriale të programeve audiovizive, ndërsa parametrat teknikë të transmetimit – përfshirë volumin – përcaktohen nga vetë operatorët e transmetimit.

Në përfundim, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s konstatoi se nuk kishte shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "***Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë***", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Sh.	Andale	You Tube	09.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit A.Sh., i cili kërkonte heqjen e një videoje ku shfaqej një vajzë e mitur, pjesë e një reportazhi të publikuar në portalin "Andale.al".

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) informoi ankuesin se AMA trajton vetëm ankesat që lidhen me ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA), pasi kjo është fusha e vetme ku operon AMA dhe Këshilli i Ankesave, në bazë të Ligjit nr. 97/2013

"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
P.A.	Gazeta Tema	You Tube	14.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit P.A., i cili kërkonte marrjen e masave ndaj disa portaleve, me pretendimin se këto media kishin shpërndarë lajme ku ai përmendej si autor i disa veprave penale. Sipas ankuesit, identiteti i tij ishte ngatërruar me një person tjetër dhe ai nuk kishte asnjë lidhje me ngjarjet ku ishte përfshirë emri i tij.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas administrimit të ankesës, Autoriteti i Mediave Audiovizive informoi zotin P.A. se AMA shqyrton vetëm ankesa që lidhen me ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA), pasi kjo është fusha e vetme e juridiksionit të saj, sipas Ligjit nr. 97/2013 ***"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"***, i ndryshuar.

Në këtë kuadër, u sqarua se mediat online dhe portalet nuk përfshihen në juridiksionin e AMA-s. Po kështu, për shkak të mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi zyrtar të platformës **YouTube** në Republikën e Shqipërisë, AMA nuk ka kompetencë ligjore për të ndërhyrë mbi përmbajtjet e publikuara në këtë platformë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.B.		You Tube	14.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) shqyrtoi ankesën e shtetasit L.B., i cili kërkonte heqjen nga platforma **YouTube** të një kënge me përmbajtje dhune.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave sqaroi se, në mungesë të një përfaqësimi dhe regjistrimi të platformës **YouTube** në Republikën e Shqipërisë, AMA nuk ka juridiksion mbi të. Po ashtu, rrjeti social **Instagram**, si pjesë e platformës "Meta", nuk ka regjistrim në territorin shqiptar dhe për pasojë mbetet jashtë juridiksionit

të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Në këtë rast, u vu në zbatim neni 2 "Fusha e zbatimit" i Ligjit nr. 97/2013 "***Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë***", i ndryshuar. Megjithatë, nga verifikimet e kryera rezultoi se videoja në fjalë ishte hequr.

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s thekson se do të vijojë, si deri tani, të trajtojë me seriozitet të gjitha ankesat dhe shqetësimet që lidhen me shkelje të Ligjit nr. 97/2013 dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023, i amenduar me vendimin nr. 107, datë 11.11.2024, si edhe të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive për rëndësinë publike të respektimit të këtyre dispozitave dhe sanksionet që burojnë nga shkelja e tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.B.		YouTube	14.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit L.B., i cili kërkonte marrjen e masave për një këngë të transmetuar në platformën **YouTube**, me pretendimin se përmbante "sjellje të dhunshme, përmbajtje të papërshtatshme, rrezik për fëmijët dhe kërcënim për sigurinë publike".

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialet e publikuara në kanalin e shpërndarjes

së videove **YouTube**, përkatësisht më datë 13 tetor 2014 dhe 20 maj 2022. Bazuar në Ligjin nr. 97/2013 "**Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë**", i ndryshuar, neni 2 i tij i jep AMA-s kompetencë mbi veprimtarinë audiovizive të OSHMA-ve dhe/ose PSV-ve.

Megjithatë, në mungesë të një përfaqësimi dhe regjistrimi të platformës **YouTube** në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion mbi të. Po ashtu, Këshilli i Ankesave vlerësoi se materialet e referuara nga ankuesi (2014 dhe 2022) janë jashtë afateve ligjore të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi për shqyrtimin e ankesave.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.P.	RTSH		17.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit E.P., e cila kishte si objekt mënyrën e ndërprerjes së marrëdhënies së tij të punës me Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH).

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga z. E.P., lidhur me pretendimin se atij dhe stafit të tij iu ndërpre marrëdhënia

e punës nga zv.drejtoresha e RTSH-së, Këshilli i Ankesave sqaroi se Autoriteti i Mediave Audiovizive është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, si dhe shërbimeve të tjera mbështetëse, në territorin e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të Ligjit nr. 97/2013, **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, konkretisht nenit 2, "Fusha e zbatimit".

Në bazë të këtij kuadri ligjor dhe akteve nënligjore që rregullojnë funksionimin e institucionit, AMA nuk ka kompetencë të ndërhyjë në marrëdhëniet kontraktuale mes subjekteve të saj, apo ndërmjet subjekteve dhe punonjësve të tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.GJ	MCN	ZONËE LIRË	24.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit A.Gj., me objekt emisionin "Zonë e Lirë", transmetuar në MCN TV.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e zotit A.Gj., e cila kishte si objekt një gjest të

moderatorit gjatë emisionit "Zonë e Lirë", transmetuar në televizionin MCN TV. Nga shqyrtimi i materialit audioviziv, rezultoi se moderatori Arian Çani, gjatë emisionit, shprehet: **"Ju bëni diferencën. E kuptoni emisionin e llumit**

nga jo llum? Me ty e kam. E kuptove? Në fije të perit është. Ti e dallon. Këtu është...", duke shoqëruar fjalët me një gjest.

Në këtë rast, gjesti i moderatorit u konsiderua si pjesë e lirisë së shprehjes dhe e përgjegjësisë editoriale, përmes së cilës ai fton audiencën për reflektim mbi përmbajtjet audiovizive, emisionin e tij dhe të tjerë, si edhe mbi situatën gjeopolitike në botë.

Këshilli i Ankesave vlerësoi se ky veprim hyn në kuadrin e lirisë së shprehjes, e cila është e garantuar nga Kushtetuta dhe kuadri rregullator në Shqipëri. Në përputhje me nenin 18 të Ligjit nr. 97/2013 **"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"**, i ndryshuar, AMA siguron ndër të tjera "ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias".

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.Y.	Tik Tok		24.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga znj. A.Y., e cila pretendon se, në emër të dy vajzave 14-vjeçare, një bashkëmoshatar ka hapur një adresë në platformën **TikTok**, përmes së cilës po denigrohen këto dy të mitura.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave informoi ankuesen se, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 06.03.2025, i cili ndalon aksesin zyrtar në platformën **TikTok** në territorin e Republikës së Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka mundësi institucionale për të ndjekur apo raportuar përmbajtje të dëmshme në këtë platformë.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.P.	Vodafone TV		28.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi E.P., i cili pretendon se platforma "Vodafone TV" transmeton programe të huaja pa përkthim në gjuhën shqipe.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi rastin në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Autoritetit, sqaron se sipas nenit 18, pika 2, shkronja **dh** të Ligjit nr. 97/2013 "**Për mediat audiovizive në**

Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ndër objektivat e AMA-s është

"nxitja e zhvillimit të shërbimeve të transmetimit dhe programeve në gjuhën shqipe". Ky përcaktim ka karakter orientues dhe synon të forcojë përdorimin dhe promovimin e gjuhës shqipe në media, por nuk paraqet detyrim të drejtpërdrejtë dhe sanksionues për OSHMA-të (Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv) për të përkthyer çdo përmbajtje audiovizive në gjuhë të huaj.

Nga verifikimi i kryer nga Drejtoria Ligjore e AMA-s, rezulton se OSHMA-ja "VTV", pjesë e platformës "Vodafone TV" dhe e pajisur me autorizimin përkatës në bazë të Ligjit dhe të Rregullores nr. 99/2017, nuk ka detyrim ligjor për të ofruar përkthim në gjuhën shqipe të përmbajtjeve të transmetuara. Detyrimet ligjore lidhen vetëm me respektimin e së drejtës së transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: Subjekti audioviziv Programi Data
A.SH **30.04.2025**

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi A.Sh., i cili denonconte disa vepra penale.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, Këshilli i

Ankesave sqaron se, referuar Ligjit nr. 97/2013, ***"Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"***, i ndryshuar, konkretisht nenit 2 ***"Fusha e zbatimit"***, i cili përcakton se "Ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove", shqetësimet e ngritura nga zoti A.Sh. nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.M.	disa portale		02.05.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga znj. F.M., e cila pretendonte se disa portale kishin deformuar një deklaratë publike të saj.

2. Administrimi i Ankesës

Ankesa u administrua nga Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, me objekt "deformimin e deklaratës nga disa televizione dhe portale".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas verifikimit të materialeve dhe lidhjeve të referuara nga ankuesja, rezultoi se:

- Gjashtë (6) nga nëntë (9) linqet i përkasin platformës së shpërndarjes së videove **TikTok**, e

cila, në bazë të VKM nr. 151, datë 6 mars 2025, "Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës online TikTok", aktualisht është e paaksesueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Tre (3) linqet e tjera i përkasin platformës **Meta** (një në Facebook dhe dy në Instagram).

Edhe pse Ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, parashikon kompetenca mbi platformat e shpërndarjes së videove, duke qenë se këto platforma nuk kanë përfaqësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, veprimtaria e tyre nuk bie nën juridiksionin e AMA-s.

Sa u përket portaleve të përmendura në ankesë, Këshilli i Ankesave informoi ankuesen se, edhe pas ndryshimeve më të fundit të Ligjit nr. 97/2013, mediat online/portalet vijojnë të mbeten jashtë fushës së veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.LI	mediat online		06.05.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit E.LI., i cili ankohej se disa media online kishin publikuar lajme ku pretendohet se ai ishte arrestuar, ndërkohë që sipas tij nuk kishte asnjë lidhje me ngjarjen.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi se rasti i referohej mediave online. Në zbatim të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 2 "Fusha

e zbatimit", ky ligj zbatohet vetëm për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove. Edhe pas ndryshimeve të fundit me Ligjin nr. 30/2023, mediat online (portalet), përfshirë rastet e keqinformimit apo cenimit të reputacionit personal, vijojnë të mbeten jashtë juridiksionit të AMA-s.

Në këtë kuadër, Këshilli i Ankesave informoi ankuesin se Autoriteti nuk ka tagër ligjor mbi portalet online dhe i rekomandoi atij që t'i drejtohet drejtpërdrejt redaksive të mediave përkatëse për korrigjimin ose heqjen e informacionit, si dhe të ushtrojë të drejtën për mbrojtje ligjore pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.A.	Pamfleti, Demaskimi		12.05.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi A.A i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me pretendimin se në faqet zyrtare të portaleve "Pamfleti" dhe "Demaskimi" ishte publikuar një lajm i pavërtetë.

2. 2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e shtetasit A.A, i cili shprehej se lajmi i

publikuar në dy portale ishte i pavërtetë dhe cenes për figurën e tij. Pas shqyrtimit, u konstatua se publikimi i referohej mediave online.

Në zbatim të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 2 "Fusha e zbatimit", ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove. Për rrjedhojë, shqetësimet e ngritura nga ankuesi mbeten jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
XH.C.	Tik Tok		19.05.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasës Xh.C., e cila pretendonte se ishte hapur një adresë në platformën "TikTok" me emrin e saj, pa dijeninë dhe pa autorizimin e saj.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Gjatë administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave konstatoi përdorimin e paautorizuar të identitetit të ankueses në platformën "TikTok". Ankuesja u informua se, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 51, datë 06.03.2025, i cili ndalon aksesin zyrtar në këtë platformë në territorin e Republikës së Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka mundësi institucionale për të ndjekur apo raportuar përmbajtje të dëmshme të publikuara aty.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.T.	Portale		26.05.2025

1. Objekti i Ankesës

R.T i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), duke pretenduar se një material i publikuar fillimisht në emisionin "Stop" në TV Klan vijonte të qarkullonte pas disa vitesh edhe në portale të ndryshme, duke cenuar privatësinë e tij.

2. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave administroi ankesën dhe konstatoi se materiali i përmendur ishte transmetuar fillimisht nga emisioni "Stop" në TV Klan, por pas kërkesës së ankuesit ishte fshirë nga ky subjekt audioviziv. Megjithatë, publikimi

i tij vijonte të mbetej i qasshëm në disa portale online.

Në këtë kuadër, Këshilli i Ankesave sqaron se, referuar Ligjit nr. 97/2013, "***Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë***", i ndryshuar, konkretisht nenit 2 "***Fusha e zbatimit***", ky ligj zbatohet vetëm për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar, qoftë offline apo online. Edhe pas ndryshimeve të fundit të kryera me Ligjin nr. 30/2023, portaleve online nuk u është zgjeruar juridiksioni nën autoritetin e AMA-s.

Për rrjedhojë, objekti i ankesës së paraqitur bie jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
F.S.	Portali BoldneWs.al		04.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit F.S., i cili pretendonte se fotografia e tij ishte përdorur nga portali **Boldnews.al** në një lajm që, sipas tij, nuk kishte asnjë lidhje me të.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën, ku shtetasi F.S. kërkonte ndërhyrjen dhe marrjen e masave për heqjen e fotos së tij personale nga portali **Boldnews.al**, duke argumentuar se fotografia ishte vendosur në një artikull që nuk kishte

asnjë lidhje me personin në fjalë apo aktivitetin e tij profesional.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Referuar Ligjit nr. 97/2013, "**Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë**", i ndryshuar, konkretisht nenit 2, "**Fusha e zbatimit**", ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Për pasojë, mediat online dhe portalet vijojnë të mbeten jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Në këtë kuadër, Autoriteti nuk ka kompetencë për të administruar ankesën.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
L.Sh.	Tring		10.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetases L.Sh., me objekt shërbimin e internetit të ofruar nga kompania "Tring".

2. Administrimi i Ankesës

Në kuadër të administrimit të ankesës, Këshilli i Ankesave evidentoi se ajo lidhej me cilësinë dhe ofrimin e shërbimit të internetit, çështje që nuk hyn në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit të Autoritetit, i cili ka kompetencë vetëm mbi transmetimet audiovizive në Shqipëri, përfshirë televizionet, radiot

dhe platformat e tjera të transmetimit mediatik.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave sqaron se, në cilësinë e autoritetit rregullator, AMA vepron në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse, sipas Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar (neni 2, "**Fusha e zbatimit**"). Referuar këtij ligji dhe akteve nënligjore përkatëse, AMA nuk ka kompetencë për të ndërhyrë në marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet ofruesve të shërbimeve të internetit dhe palëve të treta.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
G.Sh.			16.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit G.Sh., mbërritur pranë Këshillit të Ankesave, me objekt rrjetin social "Instagram".

1. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave informoi shtetasin G.Sh. se linku në rrjetin "Instagram", i dërguar përmes ankesës, nuk ishte i aksesueshëm dhe për pasojë ishte e

pamundur të trajtohej përmbajtja e tij. Gjithashtu, Këshilli sqaroi se shqetësimi i ngritur, megjithë mirëkuptimin, është jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Referuar Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht nenit 2, "**Fusha e zbatimit**", ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove, por nuk përfshin mediat sociale.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.J.	Ora News, JOQ Albania		17.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori në shqyrtim ankesën e znj. M.J., me objekt publikimin e një lajmi të pavërtetë nga "Ora News" dhe "JOQ Albania".

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e znj. M.J., e cila pretendonte se mënyra e trajtimit të lajmit në media i kishte sjellë pasoja të rënda asaj, familjes dhe biznesit të saj. Për këtë arsye, ajo kërkonte nga Autoriteti i Mediave Audiovizive marrjen e masave ndaj publikimeve në fjalë.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke mirëkuptuar ndjeshmërinë e znj. M.J. lidhur me publikimin për të cilin ankohej, ajo u informua se, bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht neni 2, "***Fusha e zbatimit***", përcakton se: "***Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet***

mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".

Materiali i publikuar në "JOQ", si portal online, bie jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ndërsa sa i takon publikimit në "Ora News", nga verifikimet e kryera nga

KA/AMA rezultoi se materiali i referohej portalit "JOQ", dhe për rrjedhojë nuk hyn në fushën e veprimit të Ligjit për mediat audiovizive.

Gjithashtu, në kushtet e mungesës së përfaqësimit dhe regjistrimit të rrjeteve sociale të platformës "Meta" (konkretisht "Facebook" dhe "Instagram") në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) nuk ka juridiksion mbi to.

Në vijim, znj. M.J. u informua se edhe pas ndryshimeve të fundit, të prillit 2023, konkretisht me Ligjin nr. 30/2023, "***Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013 'Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë'***", mediat online dhe portalet vijojnë të mbeten jashtë objektit të veprimtarisë së AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.C.	JOQ Albania		20.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mori në shqyrtim ankesën e znj. E.C., me objekt publikimin e një lajmi, sipas saj, të pavërtetë.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e znj. E.C., e cila pretendonte se më datë 19.06.2025, në faqen "JOQ Albania" (në Instagram/Facebook), ishte publikuar një postim anonim, ku përmendej kopshti publik 27/A që ajo drejtonte dhe ku akuzohej në mënyrë të pavërtetë për mbledhje të paautorizuar fondesh nga prindërit dhe për keqpërdorim të këtyre fondeve nga ana e saj. Ankuesja kërkonte që Autoriteti i

Mediave Audiovizive të merrte masa, pasi publikime të tilla dëmtojnë reputacionin, përhapin dezinformim publik dhe nxisin mosbesim e pasiguri tek komuniteti dhe prindërit.

Këshilli i Ankesave e informoi se, bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 2 "***Fusha e zbatimit***", përcakton se: "***Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar***".

Për pasojë, portali "JOQ", për sa kohë funksionon si media e shkruar elektronike dhe jo si operator audioviziv, mbetet jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.D.	JOQ Albania		18.06.2025

1. Objekti i Ankesës

A.D. i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me pretendimin se portali "JOQ Albania" kishte publikuar një lajm të pavërtetë dhe se ishte shpërndarë një foto e djalit të saj të ndjerë, H.D., në Morgun e Tiranës, pa miratimin e saj.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave administroi ankesën dhe e informoi ankuesen se, bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 97/2013 "Për

mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, konkretisht nenit 2 "**Fusha e zbatimit**", ky ligj zbatohet vetëm për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për platformat e shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.

Në këtë kuptim, publikimi në "JOQ" si portal bie jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive. Gjithashtu, për shkak të mungesës së një përfaqësimi dhe regjistrimi të rrjeteve sociale të kompanisë "Meta" (Facebook dhe Instagram) në territorin e Republikës së Shqipërisë, AMA nuk ka juridiksion mbi këto platforma.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
R.G.			30.06.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) i mbërriti një ankesë nga znj. R.G, me objekt: ***"Kërkesë për parandalimin e publikimit të të dhënave personale në mediat audiovizive"***.

2. Administrimi i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s administroi ankesën e znj. R.G, e cila pretendonte se, referuar komunikimeve telefonike të zhvilluara ndërmjet dy subjekteve, ekzistonte një rrezik i afërt dhe i parashikueshëm që shtetasi A.R. të kryente publikimin e paralajmëruar të të dhënave personale me ndjeshmëri të lartë, gjë që, sipas ankueses, do t'i shkaktonte asaj dëm të riparueshëm në jetën private. Për këtë arsye, ankuesja kërkonte ndërhyrjen e menjëhershme të AMA-s.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Duke mirëkuptuar shqetësimin e paraqitur, Këshilli i Ankesave në AMA e informoi ankuesen se Autoriteti, në cilësinë e autoritetit të pavarur rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, ushtron kompetencat e tij vetëm në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në fuqi.

Sipas nenit 2 ***"Fusha e zbatimit"***, ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.

Në këtë kuadër, aspekti i parandalimit të publikimit të të dhënave personale, siç është parashtruar në ankesë, bie jashtë kompetencave ligjore të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe nuk mund të trajtohet nga AMA.

4

Ankesa jashtë

afatit

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.H.	Top Channel (web)	Shkrim	26.02.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi E.H i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) me objekt artikullin "Gara për drejtues të RTSH-së, Këshilli Drejtues skualifikon në mënyrë të paligjshme 8 nga 10 kandidatët. Ja shkeljet gjatë votimit", publikuar nga portali top-channel.tv. Ankuesi pretendonte se lajmi ishte diskriminues, i ndërtuar në mënyrë preferenciale dhe se nuk e pasqyronte në mënyrë të drejtë informacionin.

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i materialeve të paraqitura, Këshilli i Ankesave, duke u mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, konkludoi se ankesa nuk ishte paraqitur brenda afateve ligjore. Sipas këtij neni, ankesat duhet të paraqiten me shkrim brenda 30 ditëve nga data e transmetimit ose, në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura, nga data e transmetimit më të vonë.

Përmbajtja e cituar nga ankuesi ishte jashtë këtij afati.

Në lidhje me pretendimin për "kundërvajtje penale" gjatë transmetimit, ankuesit iu sqarua se kategorizimi i një veprimi si vepër penale nuk bën pjesë në kompetencat e AMA-s, pasi kjo çështje i takon vetëm organeve gjyqësore dhe hetimore.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, duke e përcaktuar rastin si të paraqitur jashtë afateve ligjore, informoi ankuesin se Autoriteti i Mediave Audiovizive do të vijojë të trajtojë me seriozitet të gjitha ankesat dhe shqetësimet që lidhen me shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023. Po ashtu, AMA do të vazhdojë të sensibilizojë të gjithë ofruesit e shërbimeve audiovizive mbi rëndësinë e respektimit të dispozitave ligjore dhe pasojat që sjell shkelja e tyre.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
H.J.	TV Klan	Stop	29.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi E.H i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin "Stop", transmetuar më datë 02.12.2024 në televizionin "Klan".

Ankuesi pretendonte se versioni i ngjarjes i trajtuar në emision ishte i njëanshëm dhe i pavërtetë, duke u konsideruar në shkelje të standardeve të gazetarisë etike dhe profesionale.

2. Administrimi i Ankesës

Nga shqyrtimi i materialeve të paraqitura, Këshilli i Ankesave konstatoi se emisioni "Stop", i transmetuar në televizionin "Klan" më datë 29.01.2025, binte jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Referuar nenit 52 të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përcaktohet se: "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në

Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë".

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave përcaktoi se ankesa ishte paraqitur jashtë afateve ligjore dhe, për rrjedhojë, nuk mund të administrohej. Megjithatë, Autoriteti i Mediave Audiovizive e siguroi ankuesin se vijon të trajtojë me seriozitet çdo ankesë dhe shqetësim që

lidhet me shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të Kodit të Transmetimit, miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023. Gjithashtu, Autoriteti theksoi rëndësinë e sensibilizimit të të gjithë ofruesve të shërbimeve audiovizive për respektimin e dispozitave ligjore dhe pasojat që burojnë nga shkelja e tyre.

5

Komunikime tregtare

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A.B.	Report TV		18.04.2025

1. Objekti i Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori një ankesë nga shtetasi A.B., i cili kërkonte marrjen e masave ndaj "Report TV" për përdorimin e gjuhës së huaj në reklamën e miellit "Ola".

1. Administrimi i Ankesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave administroi ankesën e zotit A.B. në datë 18.04.2025, me objekt reklamën tregtare audiovizive "Ola". Nga shqyrtimi i materialit filmik rezultoi se reklama promovon një produkt ushqimor, duke e lidhur mesazhin edhe me aktualitetin e ardhjes së turistëve në vend.

Fabula e komunikimit promocial

përcjell idenë se produkti përdoret nga të gjithë, vendas dhe të huaj.

Në përmbajtjen e reklamës konstatohet përdorimi i disa shprehjeve në gjuhë të huaj, por ato shoqërohen me përkthim të titruar në shqip, ndërsa mesazhi kryesor përcillet në gjuhën shqipe.

Referuar Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përdorimi i gjuhëve të huaja në komunikimet tregtare audiovizive nuk ndalohet kategorikisht. Në rastet kur përdoret një gjuhë e huaj, kërkohet që informacioni thelbësor i reklamës të jetë i kuptueshëm për publikun shqiptar, përmes përkthimit ose titrimit.

Në rastin konkret, Këshilli i Ankesave vlerësoi se përdorimi i disa fjalive të shkurtra në gjuhë të huaj nuk cenon kuptimin e mesazhit, pasi thelbi i reklamës është i transmetuar qartë në shqip dhe i kuptueshëm për publikun.

6

Ankesa të ndryshme
dhe kërkesë për
informacion

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
B.B.	-	-	13.01.2025

1. Objekti i Kërkesës

Dr. Blerjana Bino, bashkëthemeluese dhe Drejtore Ekzekutive e "Qendrës së Shkencës dhe Inovacionit për Zhvillim (SCiDEV)", i drejtoi Këshillit të Ankesave një kërkesë për informacion me fokus: të drejtat dhe mbrojtjen e gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit, si dhe disa të dhëna nga veprimtaria e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

2. Administrimi i Kërkesës & Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së kërkesës, Këshilli i Ankesave e informoi ankuesen se AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator në fushën e transmetimeve audio dhe audiovizive, vepron mbi bazën e Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Sipas nenit 1 ("Objekti") dhe nenit 2 ("Fusha e zbatimit") të këtij ligji, kompetencat e AMA-s shtrihen vetëm mbi transmetimet audiovizive lineare, jolineare, shërbimet mbështetëse të

tyre dhe platformat e shpërndarjes së videove.

Në këtë kuadër, AMA nuk ka mandat ligjor për të hetuar apo trajtuar drejtpërdrejt rastet e kërcënimeve, sulmeve apo ngacmimeve ndaj gazetarëve, pasi kjo çështje bie jashtë juridiksionit të saj. Megjithatë, Autoriteti reagon rast pas rasti në ngjarje flagrante, që prekin masivisht punën e gazetarëve të medias audiovizive. Gjatë vitit 2024, AMA reagoi publikisht më datë 28.05.2024, pas një sulmi me lëndë shpërthyes (molotov), që rrezikoi sigurinë e reporterëve dhe kameramanëve në terren.

Në lidhje me zbatimin e Kodit të Transmetimit, Këshilli vlerësoi se ai njihet dhe zbatohet nga mediat audiovizive, ndërsa për shkak të fushatave të ndërgjegjësimit të ndërmarra nga AMA, Kodi po bëhet gjithnjë e më i njohur edhe për publikun, gjë që reflektohet në numrin dhe formulimin më të qartë të ankesave. Vetëm gjatë vitit 2024, Këshilli i Ankesave administroi **349 ankesa**, ku **72,5%** e tyre u depozituan nga individë.

3. Angazhimet ligjore dhe rregullatore të AMA-s gjatë vitit 2024

Në vitin 2024, AMA ka përqendruar angazhimin e saj në tre linja kryesore:

a. Transparenca e marrëdhënieve të pronësisë

- Në vijim të rekomandimeve të Progres-Raportit të BE 2023 për Shqipërinë dhe Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës 2024–2030, AMA miratoi me vendimin nr. 40, datë 26.04.2024, rregulloren “Për kërkesat dhe procedurat e rishikimit të ndryshimeve në strukturën e pronësisë dhe transparencën e të dhënave të pronësisë së OSHMA-ve”.
- Rregullorja përfshin: shqyrtimin e ndryshimeve të strukturës pronësore; deklarimin e pronarëve përfitues; transparencën e origjinës së financimeve; deklarimin e konflikteve të mundshme të interesit; si dhe vendimmarrjen e AMA-s rast pas rasti në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore.
- Për zbatim praktik, AMA ka krijuar dhe publikuar në faqen e saj online **Regjistrin e Pronësisë së OSHMA-ve** dhe të pronarëve përfitues, duke rritur transparencën sipas kërkesave të procesit të integritetit evropian.

b. Matja e Audiencës

- Në përputhje me Progres-Raportin e BE dhe Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës, AMA nisi procesin për ngritjen e një sistemi transparent të matjes së audiencës.
 - Gjatë janarit 2024, AMA organizoi tre tryeza pune me operatorët audiovizivë dhe agjencitë e reklamave, duke prezantuar modelet e Maqedonisë së Veriut, Kroacisë, Bullgarisë, Austrisë, Spanjës dhe Turqisë.
 - U ra dakord për krijimin e **Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI)**, me 9 anëtarë përfaqësues nga televizioni publik, televizionet kombëtare dhe rajonale, si dhe agjencitë e reklamave, si organ vendimmarrës për procesin.
- #### **c. Lufta kundër piraterisë**
- Në kuadër të Planit Kombëtar të Integritetit Evropian (2024–2026), AMA propozoi ndryshime ligjore për: futjen e konceptit të piraterisë televizive; forcimin e masave ndëshkuese ndaj transmetimeve pa të drejta; heqjen e konceptit të licencave lokale/rajonale, duke e unifikuar në një licencë kombëtare; dhe vendosjen e sanksioneve financiare për çdo ISP dhe subjekt që shkel të drejtat e transmetimit.
 - Qëllimi është mbrojtja e operatorëve ligjorë, reduktimi i humbjeve financiare dhe sigurimi i një tregu të drejtë dhe të qëndrueshëm.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
M.R.	-	-	13.01.2025

1. Objekti i Kërkesës

Shtetasja M.R i drejtoi Këshillit të Ankesave një kërkesë për informacion, me fokus platformën "TikTok" dhe kompetencat e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

1. Administrimi i Kërkesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të kërkesës për informacion, Këshilli i Ankesave e informoi ankuesen si vijon:

- Marrëdhënia e përmendur nuk përbën një marrëveshje formale, por një **marrëdhënie bashkëpunimi**, e bazuar në:
- funksionet rregullatore të AMA-s, të

përcaktuaranë Ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

- shqyrtimin e ankesave të përdoruesve shqiptarë;
- vullnetin e platformës "TikTok", e cila nuk është e regjistruar dhe nuk ka përfaqësi ligjore në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Ky bashkëpunim kishte për qëllim të mbronte interesat e përdoruesve shqiptarë të platformës, në kuadër të fushës së kompetencave që i njeh ligji AMA-s.

Në përfundim, Këshilli i Ankesave sqaroi se **ndërhyrja direkte në platformën "TikTok" është jashtë tagrit ligjor të Autoritetit të Mediave Audiovizive**, për shkak të mungesës së regjistrimit dhe përfaqësimit të saj në Shqipëri.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
L.D.	-	"Big Brother Vip Albania 4"	21.01.2025

1. Objekti i Ankesës

Shtetasi L.D i drejtoi një ankesë Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt emisionin "Big Brother Vip Albania 4", duke pretenduar se në program promovohet dhuna fizike dhe mendore ndaj një konkurrenti. Në ankesë, kërkohet ndërhyrja dhe marrja e masave nga Autoriteti.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave verifikoi linkun e referuar prej ankuesit, i cili rezultoi të ishte shpërndarë në platformën "TikTok".

Ankuesit iu bë e qartë se marrëdhënia e AMA-s me këtë platformë nuk është një marrëveshje formale, por një **marrëdhënie bashkëpunimi**, e bazuar

në:

- funksionet rregullatore të AMA-s, të përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013, të ndryshuar,
- shqyrtimin e ankesave të përdoruesve shqiptarë,
- vullnetin e platformës "TikTok" (e cila nuk është e regjistruar në Republikën e Shqipërisë), për të mbrojtur interesat e përdoruesve shqiptarë.

Në këtë kuadër, u sqarua se **ndërhyrja direkte e AMA-s në përmbajtjet e platformës**

"TikTok" është jashtë tagrit të saj ligjor. Megjithatë, ankuesit iu kërkua të paraqesë elementë konkretë që lidhen me transmetimet në mediat audiovizive (OSHMA), për të mundësuar shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës në përputhje me juridiksionin e AMA-s.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
M.D IDRA Research & Consulting	-	-	04.02.2025

1. Objekti i Kërkesës

Znj. M.D, përfaqësuese e "IDRA Research & Consulting", i drejtoi një kërkesë për informacion Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), me objekt trajtimin e ankesave që lidhen me gjuhën e urrejtjes ose diskriminimin ndaj komunitetit mysliman në transmetimet audiovizive.

2. Administrimi i Kërkesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe verifikimeve të kryera në bazën e të dhënave të Autoritetit të Mediave Audiovizive, rezultoi se gjatë periudhës së raportuar **nuk janë evidentuar raste të ankesave apo të përmbajtjeve audiovizive që përmbajnë gjuhë urrejtjeje ose diskriminim ndaj komunitetit mysliman.**

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
A. Gj	Media	Lajme	17,18,19.02.2025

1. Objekti i Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) mori disa ankesa nga shtetasi A.Gj., i cili pretendonte se deklaratat e dy politikanëve, S.B. dhe E.V., nuk duhej të transmetoheshin nga media. Po kështu, ai shprehte shqetësimin se diskutimi mbi homoseksualitetin në emisionin "Ftesë në 5", transmetuar në televizionin "Top Channel" në orën 17:05, ishte i papërshtatshëm për atë fashë orare, pasi fëmijët mund të ndodheshin para ekranit.

2. Administrimi i Ankesave

Pas marrjes së ankesave, Këshilli i Ankesave nisi shqyrtimin e tyre. Nga verifikimi i materialeve, u konstatua se kërkesa për moslejimin e transmetimit të deklaratave bie ndesh me parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Konkretisht, neni 4, pika 1/a, përcakton se "veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë". Po ashtu, neni

4, pika 2/a, neni 64, pika 2/b, si dhe neni 78, pika 1, theksojnë se ushtrimi i përgjegjësisë editoriale është pjesë e lirisë së shprehjes, e garantuar nga Kushtetuta dhe nga kuadri ligjor për mediat audiovizive.

Në këtë kuadër, Autoriteti i Mediave Audiovizive, si autoritet rregullator, nuk ka kompetencë të ndërhyjë në politikat editoriale të operatorëve, për sa kohë nuk evidentohen shkelje të dispozitave të ligjit apo të Kodit të Transmetimit.

Në lidhje me pjesën tjetër të ankesës, Këshilli i Ankesave shqyrtoi përmbajtjen e emisionit "Ftesë në 5", ku ishte diskutuar vendimi i presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, për ndalimin e sportistëve transgjnorë në sportet e femrave dhe në ushtri.

Diskutimi në studio u fokusua në dilemat mbi kufirin mes identitetit dhe avantazhit fizik, duke përfshirë edhe aspekte të orientimit seksual. Në panel u ballafaquan mendime të ndryshme, si pro, ashtu edhe kundër, duke e paraqitur çështjen në mënyrë të ekuilibruar.

3. Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në vendimmarrjen e tij, Këshilli i Ankesave vlerësoi se trajtimi i çështjeve të tilla në media, përmes përballjes së argumenteve të kundërta, kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit publik mbi komunitetin LGBTQ+, duke ndihmuar në uljen e diskriminimit dhe paragjyqimeve ndaj tij. Kjo përbën

një hap pozitiv drejt përfshirjes dhe pranimit më të gjerë shoqëror.

Për këto arsye, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, pas shqyrtimit të përmbajtjes së referuar, **nuk konstatoi shkelje të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e**

Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
D.O.	-	-	13.03.2025

1. Objekti i Kërkesës

D.O. i drejtoi një kërkesë për informacion Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku kërkoji sqarime lidhur me:

- publikimin e raporteve vjetore mbi shkeljet dhe sanksionet ndaj mediave audiovizive;
- masat administrative e ligjore që AMA merr në rastet e shkeljeve të rënda etike, cenimit të sigurisë publike dhe mbrojtjes së të miturve;
- mënyrën e trajtimit të reality show-ve dhe programeve me ndikim të gjerë tek audienca.

2. Administrimi i Kërkesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kthimin e përgjigjes drejtuar D.O, Autoriteti i Mediave Audiovizive sqaroi çështje të ndryshme, lidhur me kërkesat e parashtruara.

Sa i takon publikimit të raporteve, iu bë me dije se **raporti vjetor mbi sanksionet administrative ndaj**

subjekteve të licencuara publikohet çdo vit, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Kuvendi, dhe është i aksesueshëm në faqen zyrtare të AMA-s. Për vitin 2024, raporti është përgatitur, është depozituar në Kuvend dhe do të publikohet menjëherë pas përfundimit të procedurës parlamentare. Në këtë raport përfshihen edhe shkeljet e etikës dhe të kodeve të sjelljes nga televizionet kombëtare.

Sa i takon **masave administrative ndaj shkeljeve të rënda**, AMA sqaroi se, në rastet kur konstaton shkelje që cenojnë etikën, sigurinë publike apo ndikojnë negativisht te fëmijët dhe të rinjtë, ajo ndërmerr masa konkrete, në përputhje me Ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe Kodin e Transmetimit. Këto masa mund të jenë: paralajmërime, gjoba administrative, kërkesa për rishikimin e përmbajtjes apo orarit të transmetimit, pezullime të përkohshme dhe, në raste ekstreme, deri te revokimi i licencës së transmetimit. AMA theksoi se ndjek gjithmonë një **qasje proporcionale**, duke garantuar mbrojtjen e interesit publik dhe të drejtën për informim.

Në rastet kur përmbajtjet audiovizive **nxisin trazira, shpërndajnë panik, përmbajnë thirrje për dhunë ose rrezikojnë sigurinë publike**, AMA ka detyrimin të vendosë masa administrative, por edhe të njoftojë organet kompetente për ndjekje penale, pasi bëhet fjalë për sjellje që mund të përbëjnë vepra penale.

Në lidhje me **reality show-t**, iu bë e qartë se AMA nuk ushtron **kontroll paraprak** mbi përmbajtjen e programeve, por vepron pas transmetimit, përmes monitorimit dhe shqyrtimit të ankesave. Nëse konstatohet se programe të tilla:

- nxisin dhunë apo konflikte për efekt spektakli,
- përsërisin sjellje manipulues apo

denigruese,

- shkelin vazhdimisht standardet për mbrojtjen e publikut,

atëherë AMA mund të marrë masa progresive, sipas nenit 133 të Ligjit nr. 97/2013, duke filluar nga paralajmërimi, gjoba administrative, ndryshimi i orarit të transmetimit, deri te pezullimi i përkohshëm ose përfundimtar i programit.

Në përfundim, AMA theksoi se nuk ushtron censurë paraprake, por mbështetet në mekanizmat e monitorimit të vazhdueshëm dhe në ankesat e publikut, duke synuar të garantojë një ekuilibër mes **lirisë së shprehjes, mbrojtjes së të miturve dhe interesit publik**.

Ankesa e paraqitur nga:	Subjekti audioviziv	Programi	Data
E.D.	-	-	17.03.2025

1. Objekti i Kërkesës

E.D i drejtoi një kërkesë për informacion Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), duke kërkuar sqarime mbi funksionet dhe kompetencat e Këshillit të Ankesave, procedurat e paraqitjes së ankesave nga qytetarët dhe llojet e masave disiplinore që AMA merr ndaj subjekteve audiovizive në rast shkeljesh.

2. Administrimi i Ankesës dhe qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Në kthimin e përgjigjes drejtuar E.D, Autoriteti i Mediave Audiovizive sqaroi çështje të ndryshme, lidhur me kërkesat drejtuar Autoritetit. Referuar pyetjeve të parashtruara, iu bë me dije se "Këshilli i Ankesave është strukturë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe ndër funksionet e tij është edhe shqyrtimi i ankesave sipas neneve 51, 52 dhe 53 të Ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" (neni 20, pika 3/b). Këshilli i Ankesave shqyrton çdo ankesë që i drejtohet AMA-s

lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve në shkelje të kërkesave të nenit 33 të Ligjit nr. 97/2013 dhe të Kodit të Transmetimit.

Një ankesë i dërgohet Autoritetit të Mediave Audiovizive, konkretisht:

- përmes plotësimit të një "Formulari Ankesë" për shkeljen e Kodit të Transmetimit, ku përcaktohet saktësisht subjekti audioviziv, data dhe ora e transmetimit; formulari gjendet në faqen zyrtare të AMA-s (ama.gov.al);
- me e-mail në adresën elektronike: info@ama.gov.al;
- ose përmes shërbimit postar/dorazi në Zyrën e Protokollit të AMA-s.

Sa u takon masave disiplinore, AMA, si autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, në bazë të Ligjit nr. 97/2013 dhe legjislacionit në fuqi, ka dy lloj vendimmarrjesh:

1. **Tërheqje vëmendje**, kur shkeljet janë më të lehta;
2. **Sanksion financiar**, kur shkeljet janë më të rënda dhe ndikojnë negativisht në publik.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
E.P.	-	-	21.03.2025

1. Objekti i Ankesës

E.P i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), duke pretenduar se subjekti audioviziv ku punonte i kishte ndërprerë kontratën e punës në mënyrë të njëanshme dhe kërkonte ndërhyrjen e institucionit për zgjidhjen e këtij konflikti.

2. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave evidentoi se çështja e ngritur ishte jashtë kompetencave ligjore të Autoritetit. AMA, si autoritet i pavarur rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë,

vepron në zbatim të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në nenin 2 të këtij ligji përcaktohet qartë fusha e zbatimit, e cila nuk përfshin ndërhyrjen në marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet subjekteve mediatike dhe punonjësve të tyre.

Në përputhje me këtë kuadër ligjor, AMA nuk ka tagër për të ndërhyrë në marrëdhënie pune dhe kontrata punësimi. Megjithatë, në respektim të nenit 1 të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe AMA-s, që parashikon shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional, ankesa e E.P u përcoll pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës për shqyrtim dhe trajtim të mëtejshëm në përputhje me kompetencat e tij ligjore.

<u>Ankesa e paraqitur nga:</u>	<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
O.J.	-	-	31.03.2025

1. Objekti i Ankesës

O.J. i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), duke pretenduar se reklamat në mediat audiovizive transmetohen me volum të lartë dhe të ndryshëm nga njëra-tjetra, në blloqe të ndryshme transmetimi.

1. Administrimi i Ankesës dhe Qëndrimi i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, pasi shqyrtoi

ankesën, vlerësoi se shqetësimi i ngritur lidhet me parametrat teknikë të transmetimit. Referuar nenit 2, "Fusha e zbatimit", të Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ky ligj zbatohet për transmetimet e mediave audiovizive lineare, transmetimet jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre, si dhe për shërbimet e platformave të shpërndarjes së videove. Kompetencat e AMA-s përfshijnë përmbajtjen, etikën dhe standardet editoriale të programeve audiovizive, por jo parametrat teknikë të transmetimit, të cilët përcaktohen nga vetë operatorët e transmetimit.